



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 10/2023 regjistër (JR)  
Datë 07.03.2023

Nr. 47 i vendimit  
Datë 03.11.2023

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Relatore</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 03.11.2023, ditën e premte, në orën 09:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 10/2023, datë 07.03.2023, që i përket:

**ANKUESE:** Komisionerja Publike Irena Nino.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 595, datë 07.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Arbër Çela.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet C, pika 2 e F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e Komisioneres Publike të paraqitura në ankim dhe në konkluzionet përfundimtare, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 595, datë 07.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, shqyrtoi dhe dëgjoi parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit Arbër Çela dhe avokatit të tij Julian Mërtiri, të cilët kërkuan përfundimisht lënien në fuqi të vendimit nr. 595, datë 07.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Arbër Çela (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, bazuar në parashikimet e nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar *ex officio* procesit të rivlerësimit kalimtar.
2. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport<sup>1</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
  - (i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;
  - (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
  - (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
  - (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
  - (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
3. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), pasi kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të

---

<sup>1</sup> Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Arbër Çela, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është përcjellë në Komision nga ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 16.11.2018.

Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dërgoi një raport<sup>2</sup> pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me anë të të cilit ka referuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit.

4. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga vetë subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, duke dërguar pranë Komisionit një raport<sup>3</sup> të hollësishëm, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
5. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga organet ndihmëse, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit – vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

## II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

6. Komisioni, me vendimin nr. 595, datë 07.12.2022, në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, vendosi:
  1. *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Arbër Çela, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. [...].*
7. Këtë vendim, Komisioni e ka mbështetur mbi konkluzionet e arritura për secilin nga kriteret e rivlerësimit, si vijojnë.

### 7.1 Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë:

*Trupi gjykues vlerëson se në analizën që i bën situatës faktike për llogari të procesit të rivlerësimit: kualifikimin ligjor të shtetases E. Zh. si bashkinvestitore në pasurinë apartament me sipërfaqe 91,91 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, mundësitë financiare të shtetasit F. H., për huadhënien, e cila është zëvendësuar në vijim brenda vitit kalendarik me kredinë bankare, mbajtur në konsideratë edhe trajtimin ligjor prej Kolegjit në raste të ngjashme, vlerëson se pasuria e subjektit të rivlerësimit Arbër Çela është krijuar në mënyrë të ligjshme dhe nuk ka mungesë burimesh financiare të ligjshme. [...] Në këto rrethana, trupi gjykues vlerëson se subjekti përmbush nivelin*

---

<sup>2</sup> Raporti nr. {\*\*\*} prot., datë 20.05.2022, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KZHD-së nr. {\*\*\*} prot., datë 24.05.2022, është përcjellë në Komision nga DSIK-ja, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.05.2022.

<sup>3</sup> Raporti për analizimin e aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit Arbër Çela” i KLGj-së, me nr. {\*\*\*} prot., datë 26.02.2020.

*e kërkuar të provueshmërisë së parashikuar nga neni 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe se ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e kontrollit të pasurisë.*

**7.2** Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës:

*Subjekti i rivlerësimit, z. Arbër Çela, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

**7.3** Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

*Trupi gjykues, pasi analizoi të gjitha gjetjet e paraqitura në rezultatet e hetimit, i analizoi në raport me shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, gjatë prapësimeve të tij dhe atyre në seancën dëgjimore publike, arriti në konkluzionin se disa prej gjetjeve përfaqësojnë vlerësime e qëndrime në kapërcim të objektit të organeve të rivlerësimit lidhur me kontrollin e këtij kriteri, përpos gjetjeve që u konstatuan të pambështetura në ligj dhe fakte, sipas vlerësimit të trupit gjykues. Disa nga gjetjet e konstatuara janë të tilla që nuk mjaftonin për të kualifikuar aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit si nën nivelin minimal kualifikues, për pasojë, në analizë të të gjitha rrethanave të çështjes dhe kuadrit ligjor në fuqi, arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit arrin nivelin minimal kualifikues në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale për efekt të këtij procesi, në kuptim të zbatimit të nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.*

**7.4** Në lidhje me vlerësimin për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë:

*Sa u përket çështjeve të trajtuara në kreun B, “Kontrolli i figurës”, trupi gjykues, nga një vlerësim i thellë i situatës, vlerësuar sipas kriterëve të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, ku vlerësuesi duhet të çmojë aftësitë e gjyqtarit pa gjykuar korrektesinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet, çmon se në gjetjet e rezultateve të hetimit, në raport me shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij, problematikat e hasura janë çështje gjyqësore që duhen zgjidhur nga gjykatat më të larta, duke mos cenuar lirinë dhe të drejtat e gjyqtarit në vendimmarrje. [...] Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se nuk ka vend për aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi në bindjen e tij të brendshme ato janë çështje që kanë të bëjnë me zgjidhjen e themelit të çështjes e që duhen trajtuar në shkallët më të larta të gjykimit. Në këtë qëndrim, trupi gjykues ka mbajtur në vëmendje edhe qëndrimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.*

### **III. Shkaqet e ankimit të Komisioneres Publike**

8. Komisionerja Publike Irena Nino, në mbështetje të rekomandimit<sup>4</sup> për paraqitje ankimi, të nënshkruar nga tre vëzhgues ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, ka

---

<sup>4</sup> Shih rekomandimin e ONM-së nr. {\*\*\*} prot., datë 06.02.2023, në faqen zyrtare në internet të Institucionit të Komisionerëve Publikë, në linkun në vijim: <https://ikp.al/wp-content/uploads/2023/02/Rekomandim-p%3%abr-vendimin-e-KPK-s%3%ab-nr.-595-dat%3%ab-7.12.2022-Final.pdf>.

paraqitur ankim<sup>5</sup> kundër vendimit nr. 595, datë 07.12.2022, të Komisionit, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Arbër Çela, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

9. Referuar ankimit, Komisionerja Publike, nga shqyrtimi i vendimit nr. 595, datë 7.12.2022, ka çmuar se ai është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'iu paraqitur për shqyrtim nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, ankimi i Komisioneres Publike ka evidentuar dhe parashtruar si çështje për gjykim, rrethanat dhe faktet ligjore, për të cilat çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me: *(i) rezultatet e hetimit mbi kontrollin e kriterit të pasurisë; (ii) rezultatet e hetimit mbi vlerësimin profesional dhe ato të dala si gjetje në kontrollin e figurës.*

Komisionerja Publike, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë.

10. Komisionerja Publike, bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, si dhe neneve 30-44, 4, pika 2 e nenit 61, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, ka kërkuar që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji të vendosë:
- o Ndryshimin e vendimit nr. 595, datë 7.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arbër Çela.
11. Shkaqet e ankimit të Komisioneres Publike paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

*A. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë*

12. Komisionerja Publike, në analizë të akteve të administruara nga Komisioni, bazuar në Rekomandimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, i është drejtuar juridiksionit kontrollues të Kolegjit, për pasurinë “apartament me sip. 91,91 m<sup>2</sup>” në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, (në vijim “apartamenti”), për çështjet:
- (i) pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme financiare të subjektit të rivlerësimit për të investuar në përputhje me kontributin e tij real, për këtë pasuri;
  - (ii) pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme financiare të bashkëpronares E. Zh., për të investuar bashkërisht në blerjen e këtij apartamenti;

---

<sup>5</sup> Shih ankimin e Komisionerit Publik me nr. {\*\*\*} prot., datë 21.02.2023, në faqen zyrtare në internet të Institucionit të Komisionerëve Publikë, në linkun në vijim:

<https://ikp.al/2023/02/21/ankim-kunder-vendimit-nr-595-date-7-12-2022-te-kpk-se-per-subjektin-e-rivleresimit-z-arber-cela/>.

(iii) pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme financiare të huadhënësit, z. F. H., për t'i dhënë subjektit të rivlerësimit huanë në shumën 30.000 euro, e cila u përdor si burim për blerjen e kësaj pasurie.

*B. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe ato të dala si gjetje në kontrollin e figurës*

13. Komisionerja Publike, bazuar dhe në rekomandimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, datë 06.02.2023, ka kundërshtuar vendimin e Komisionit nr. 595, datë 07.12.2022, lidhur me përfundimet e arritura pas shqyrtimit e vlerësimit të çështjeve gjyqësore, referuar *informacionit të organit ligjzbatues*, përfshirë edhe ato të analizuara në kontrollin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale për shkak të *denoncimeve të publikut*. Në lidhje me këto çështje, Komisionerja Publike ka konstatuar se rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuara së bashku me rezultatet e tjera të hetimit administrativ, në vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, si dhe të para në raport me njëra-tjetrën, duhen çmuar nga Kolegji, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

*A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit*

*a) Juridiksioni i Kolegjit*

14. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisioneres Publike dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, në përputhje me arsyetimin në vijim në këtë vendim.

*b) Legjitimimi i ankuesit*

15. Komisionerja Publike legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

*c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

16. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisioneres Publike ndaj vendimit të Komisionit nr. 595, datë 07.12.2022, për subjektin e rivlerësimit Arbër Çela, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve.
17. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, në seancën gjyqësore publike të datës 28.09.2023, subjekti i rivlerësimit, në vijim të parashtrimeve, kërkoi riçeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin e akteve të reja që do t'i shërbenin hetimit dhe shqyrtimit të plotë të çështjes. Në seancat gjyqësore të datave 04.10.2023 dhe 26.10.2023, trupi gjykues, në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të administrojë në cilësinë e provës aktet shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për sa ato lidheshin me shkaqet e ankimit dhe nevojën e subjektit të rivlerësimit për t'i prapësuar, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Trupi gjykues ia nënshtroi ato debatit gjyqësor e më pas i vlerësoi ato në raport me vendimin objekt shqyrtimi dhe shkaqet e ankimit të Komisioneres Publike.
18. Në kuadër të denoncimit nga publiku të depozituar në Kolegj nga denoncuesi Th. H.<sup>6</sup>, vënë në dispozicion paraprakisht subjektit të rivlerësimit dhe Komisioneres Publike, nga subjekti i rivlerësimit, në seancën gjyqësore të datës 28.09.2023, u paraqitën parashtrime, si dhe aktet shkresore në mbështetje të tyre, të administruara nga Kolegji në cilësinë e provës<sup>7</sup>, duke pretenduar se rrethanat e parashtruara nga denoncuesit janë të pavërteta. Komisionerja Publike, pasi u njoh me parashtrimet e subjektit të rivlerësimit mbi denoncimin, në seancën gjyqësore të datës 04.10.2023, parashtrroi se verifikimi i informacionit të përcjellë në denoncim nuk do ndikonte në ndryshimin e kërkimit përfundimtar të paraqitur në ankimin e depozituar prej tij në Kolegj, duke e lënë në vlerësimin e trupit gjykues çmimin për sa më sipër. Në seancën gjyqësore të datës 04.05.2022, trupi gjykues, pasi shqyrtoi denoncimin dhe rrethanat e parashtruara në të, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të mos çelë hetimin gjyqësor pasi denoncimi i depozituar nuk plotësonte kriteret e përcaktuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016.
19. Në seancën gjyqësore publike të datës 26.10.2023, në konkluzionet përfundimtare, Komisionerja Publike, në vlerësim edhe të provave të administruara në kuadër të këtij gjykimi, kërkoi nga Kolegji ndryshimin e vendimit nr. 595, datë 07.12.2022, të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arbër Çela.

---

<sup>6</sup> Denoncim i regjistruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 06.09.2023.

<sup>7</sup> Në seancën gjyqësore të datës 04.10.2023.

20. Subjekti i rivlerësimit, në konkluzionet përfundimtare, i kërkoi Kolegjit lënien në fuqi të vendimit nr. 595, datë 07.12.2022, të Komisionit.
21. Në përfundim të hetimit gjyqësor, trupi gjykues vlerësoi shkaqet e ngritura në ankim dhe pretendimet përfundimtare të Komisioneres Publike, parashtrimet dhe pretendimet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, duke analizuar e vlerësuar të gjitha provat që gjendeshin në dosjen e hetimit administrativ të krijuar nga Komisioni, si dhe ato të cilat u morën gjatë procesit gjyqësor në Kolegj dhe që iu nënshtuan debatit gjyqësor prej palëve.

*B. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë*

22. Lidhur me shkakun e ankimit të Komisioneres Publike, sipas të cilit: *për pasurinë “apartament me sipërfaqe 91,91 m<sup>2</sup>”, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016*, trupi gjykues konstatoi sa më poshtë.
23. Komisioni, në vlerësimin e pasurisë objekt kontrolli gjatë procesit të rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se kjo pasuri është e ligjshme në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka arsyetuar si vijon.  
*14.53 Trupi gjykues [...] konkludon se investimi i subjektit të rivlerësimit në pasurinë apartament banimi në Tiranë, është në shumën 36.764 euro (ose 50%), duke e konsideruar znj. E. Zh. si bashkinvestitore në këtë pasuri. Në këtë konkluzion të arritur nga trupi gjykues, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë. Lidhur me mundësitë financiare me burime të ligjshme për të investuar shumën 36.764 euro, nga hetimi rezultoi se ai ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e saj, duke pranuar dhe marrë në konsideratë huanë e shtetasit F. H. si burim primar në shumën 30.000 euro dhe kredinë hipotekore të marrë brenda vitit 2013 si burim fundor, kursimet e tij në shumën 387.540 lekë ose 2.764 euro, si dhe dhuratë nga prindërit në shumën 4.000 euro.*
24. Pretendimet e parashtruara nga Komisionerja Publike lidhur me shkakun e mësipërm të ankimit, kundërshtojnë konkluzionet e Komisionit lidhur me përfundimet e arritura mbi burimet e krijimit të pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 91,91 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë (në vijim “apartamenti”), pasurisë së vetme të paluajtshme të subjektit të rivlerësimit, për të cilën rezultoi si vijon.

**24.1** Origjina e pasurisë “apartament me sipërfaqe 91,91 m<sup>2</sup>, në Tiranë”, regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Tiranë me nr. pasurie {\*\*\*}, {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}, rrjedh nga kontrata e porosisë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.05.2013 dhe kontrata e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.06.2015, të lidhura ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe znj. E. Zh. në cilësinë e palës blerëse, si dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK në cilësinë e palës shitëse,



në shumën 73.528 euro. Pasuria është regjistruar në regjistrin publik të pasurive më datë 26.05.2015, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe znj. E. Zh., në pjesë takuese 50%.

**24.2** Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar: *Apartament me sipërfaqe 91,91 m<sup>2</sup>, rr. “{\*\*\*}” (rrugica {\*\*\*}), Tiranë. Vlera: 73.528 euro. Vlera e pjesës në pronësinë time 36.764 euro. Pjesa takuese: 50%.*

*Burimi: 1. Kontratë kredie bankare nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*}kol., në shumën 30.000 euro.*

*2. Dhuratë nga prindërit në shumën 4.000 euro (bashkëngjitur deklarata datë 25.01.2014, nr. {\*\*\*}rep., nr. {\*\*\*}kol.). 3. Kursimet personale.*

*Apartamenti është në bashkëpronësi me shtetasen E. Zh.. Për aftësinë blerëse të bashkëpronares bashkëngjitur: vërtetim, datë 20.10.2016, nga Zyra e Tregtisë Turke; vërtetim, datë 25.01.2017, {\*\*\*}; deklarata noteriale huaje; vërtetim nr. {\*\*\*}, datë 25.01.2017.*

**25.** Komisionerja Publike, në ankim dhe në parashtrimet gjatë gjykimit në Kolegj, kundërshtoi si të pabazuar arsyetimin dhe konkluzionin e Komisionit, me pretendimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë e të pamjaftueshëm lidhur me pasurinë objekt kontrolli, për shkak të:

(i) pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme financiare të subjektit të rivlerësimit për të investuar në përputhje me kontributin e tij real, për këtë pasuri;

(ii) pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme financiare të bashkëpronares E. Zh., për të investuar bashkërisht në blerjen e këtij apartamenti;

(iii) pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme financiare të huadhënësit, z. F. H., për t'i dhënë subjektit të rivlerësimit huanë në shumën 30.000 euro, e cila u përdor si burim për blerjen e kësaj pasurie.

**26.** Në shqyrtim të këtyre pretendimeve të Komisioneres Publike, trupi gjykues analizoi si më poshtë.

**27.** Në lidhje me pretendimin e Komisioneres Publike se *ekzistojnë gjetje në lidhje me kontributin real të subjektit të rivlerësimit në krijimin e pasurisë apartament*, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

**28.** Komisioni, në vendim<sup>8</sup>, në verifikim dhe kontroll të pagesës së kryer nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e pasurisë apartament, ka arsyetuar:

*Lidhur me marrëdhënien e bashkëpronësisë dhe pjesën takuese të subjektit të rivlerësimit në pasurinë apartament me sipërfaqe 91,91 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, blerë me kontratën e porosisë, datë 14.05.2013, për çmimin 73.528 euro, trupi gjykues çmon se elementet e rezultuara nga hetimi, konkretisht, pagesat e kryera në bankë në datat 14 dhe 15 maj 2013 nga shtetasit Arbër Çela dhe E. Zh., të vlerësuar në raport edhe me veprime të mëvonshme, si shitja nga ana e znj. E. Zh. të pjesës së saj takuese, për vlerën 40.000 euro, transaksion i kryer përmes bankës, administrimi dhe mbajtja e shumës në llogarinë e saj dhe më pas investimi i saj në krijimin e një pasurie të re, megjithëse janë kryer pas plotësimit të deklaratës “vetting”, vlerësohet se duhen*

---

<sup>8</sup> Paragrafi 14.52 i vendimit të Komisionit.

*çmuar si prova, pasi krijojnë bindjen se znj. E. Zh. ka qenë realisht bashkëpronare në 50% pjesë takuese në krijimin e pasurisë objekt hetimi. Trupi gjykues krijoi bindjen se pjesa takuese e subjektit të rivlerësimit Arbër Çela është 50%. Parë në këtë këndvështrim, trupi gjykues vlerëson se edhe hetimi lidhur me burimet e ligjshme duhet bërë deri në vlerën 36.764 euro, e duke e konsideruar shtetasen E. Zh. si investitore dhe jo një person tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit.*

29. Komisionerja Publike, në ankim dhe në parashtrimet gjatë gjykimit në Kolegj, kundërshtoi si të pabazuar arsyetimin dhe konkluzionin e Komisionit si më sipër, me pretendimin se ka prova të qarta nga informacioni i vënë në dispozicion nga institucioni bankar, se subjekti i rivlerësimit faktikisht ka paguar shumën prej 57.250 eurosh ose 78% të çmimit të blerjes së apartamentit. Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të justifikojë burimin e ligjshëm të shumës prej 57.250 eurosh në momentin e depozitimit të saj në *cash* në sistemin bankar, provuar nga mandatpagesat e vëna në dispozicion të hetimit në Komision, si dhe përshkrimet respektive të tyre. Në vlerësimin e Komisioneres Publike, edhe gjatë gjykimit në Kolegj, mbeti i provuar i njëjti fakt, pasi shkresa e Tirana Bank, e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë shkak ankimi, nuk provoi sa pretenduar nga ai. Sipas Komisioneres Publike, përmbajtja e shkresës së institucionit bankar nuk e përjashton subjektin e rivlerësimit nga detyrimi që ka pasur për të paguar pjesën e tij takuese sipas kontributit real financiar ose, më së paku, për të treguar kujdesin minimal si magjistrat për të detajuar në përshkrimin e transaksionit të kryer kontributin e tij, parë kjo edhe në kuadër të detyrimit të tij si subjekt deklarues për shkak të pozicionit që mbante në kohën e transaksionit.
30. Lidhur me këtë shkak të ankimit, gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit argumentoi se pretendimet e Komisioneres Publike lidhur me pagesën e kryer prej tij për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, janë të pabazuara. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendoi, në mënyrë të përmbledhur, si vijon. Bashkëpronësia e subjektit të rivlerësimit në pasurinë “apartament” është një bashkëpronësi në pjesë dhe jo në tërësi. Në certifikatën e pronësisë, lëshuar në momentin e regjistrimit të pasurisë, specifikohet saktësisht pjesa e tij takuese prej 50%. Subjekti i rivlerësimit dhe znj. E. Zh. kanë qenë të dy personalisht në bankë në momentin e derdhjes së shumës në *cash*, në llogarinë e shoqërisë ndërtuese. Pasi kanë dalë nga zyra noteriale ku kanë nënshkruar kontratën bashkërisht, znj. Zh. ka shkuar në banesën e saj për të marrë pjesën e saj të kursimeve në *cash* e më pas ata janë paraqitur në bankën më të afërt me banesën e saj. Sistemi bankar lejon që pagesa e depozitimit në *cash* të kryhet në sportelin bankar vetëm nga një person. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar gjithashtu se lidhur me përshkrimin e burimit, rezulton e provuar se në të dyja mandatet bankare janë përdorur termat “kursime” dhe “huamarrje”, burime këto që i përkisnin secilit bashkëpronar për pjesën e tij të investimit. Ky specifikim nuk është arritur të bëhet në përshkrimin e mandatit bankar, jo vetëm për shkak të numrit të kufizuar të karaktereve që përdoren në të, por edhe prezumimit ligjor të barazisë së pjesëve edhe në investim.

31. Në shqyrtim të këtyre pretendimeve të Komisioneres Publike, trupi gjykues analizoi faktet dhe rrethanat e konstatuara gjatë hetimit administrativ në Komision e gjatë gjykimit në Kolegj, dhe vlerësoi në mënyrë integrale e në harmoni si vijon.

(i) Deklarimi i pjesës takuese prej 50% në pasurinë “apartament”, si dhe i pagesës për blerjen referuar kësaj pjese, nuk është një deklaram i posaçëm, i kryer nga subjekti i rivlerësimit vetëm në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, por është bërë rregullisht, në mënyrë konstante, në deklaramin periodik të interesave të vitit 2013<sup>9</sup>, si dhe në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI për shkak të kontrollit të ushtruar nga ky institucion mbi deklaramet e interesave periodikë të subjektit për periudhën 2010-2013<sup>10</sup>.

(ii) Në kontratën e porosisë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.05.2013 dhe kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.06.2015, të lidhura ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe znj. E. Zh. në cilësinë e palës porositëse/blerëse, si dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK në cilësinë e palës sipërmarrëse/shitëse, nuk ka parashikime për pjesën takuese apo kontributin e secilit prej porositësve/blerësve. Fakti i bashkëpronësisë në pjesën takuese 1/2 ose 50%, vërtetohet nga certifikata për vërtetim pronësie, lëshuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, më datë 26.06.2015.

(iii) Shoqëria sipërmarrëse/shitëse “{\*\*\*}” ShPK<sup>11</sup> i ka vënë në dispozicion Komisionit shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 16.05.2013, “Konfirmim bankar”, të Tirana Bank, sipas së cilës në datë 14.05.2013, z. Arbër Çela ka depozituar në llogari të “{\*\*\*}” ShPK, shumën prej 57.250 eurosh, me përshkrim të saktë të veprimit: *Blerje apartamenti, kontratë porosie ndërmjet “{\*\*\*}” ShPK, me përfaqësues ligjor znj. S. H. dhe E. Zh. dhe Arbër Çela, sipas kontratës së porosisë së paraqitur në bankë nga depozituesi i shumës së lartpërmendur.*

Sa më sipër përbën përshkrimin e plotë të transaksionit të kryer, në të cilin identifikohen qartë palët në emër të të cilave është kryer veprimi bankar, subjekti i rivlerësimit dhe znj. Zh.. Fakti që ky transaksion nuk përbënte pagesën totale të shlyerjes së detyrimit ndaj shoqërisë, bën pa relevancë diskutimin nëse subjekti duhet të ishte treguar i kujdesshëm për të detajuar në përshkrim kontributin përkatës të tij. Rëndësi të posaçme për vlerën provuese të konfirmimit bankar si një akt i krijuar në kohën kur ka ndodhur transaksioni për pagimin e një pjese të çmimit të blerjes së pasurisë, merr fakti që në përshkrim janë saktësuar palët në emër të të cilave është kryer transaksioni, duke potencuar në këtë mënyrë që e gjithë shuma prej 57.250 eurosh nuk ishte paguar vetëm në favor të subjektit të rivlerësimit, por edhe në favor të znj. E. Zh..

(iv) Tirana Bank i ka vënë në dispozicion Komisionit<sup>12</sup>, mandatet bankare, sipas të cilave: z. Arbër Çela ka depozituar *cash* më datë 14.05.2013, shumën prej 57.250 eurosh, në llogari të

<sup>9</sup> Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Apartament me sipërfaqe 91,91 m<sup>2</sup>, rr. “{\*\*\*}”, Tiranë. Burimi: Kontratë kredie + dhuratë nga prindërit. Vlera totale 73.528 euro, paguar 50% sipas pjesës”.

<sup>10</sup> Referuar procesverbalit të ILDKPKI-së, datë 20.10.2014 – përgjigjja e pyetjes nr. 4.

<sup>11</sup> Informacioni i përcjellë në Komision me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 14.06.2022.

<sup>12</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 07.06.2022 dhe shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 07.06.2022.

“{\*\*\*}” ShPK, me përshkrimin: *Likuidim total apartamenti rep. {\*\*\*}, kol. {\*\*\*}, datë 14.05.2013, ap {\*\*\*}, Kursim + Huamarrje. Burimi i fondeve: Individ Kursim +Huamarrje*”. Znj. E. Zh., më datë 15.05.2013, ka depozituar *cash* shumën prej 16.278 eurosh në llogari të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me përshkrimin: *Likuidim total apartamenti rep. {\*\*\*}, kol. {\*\*\*}, datë 14.05.2013, ap. {\*\*\*}, Të ardhurat: Kursime + Huamarrje.*

(v) Tirana Bank i ka vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit<sup>13</sup>, shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 21.09.2023, me të cilën e informon se: *Lidhur me pagesat me para në dorë në favor të palëve të treta, respektivisht për rastin tuaj “pagesë për kontratë porosie”, Banka e Tiranës ShA nuk e ka të përcaktuar me procedurë nënshkrimin e mandatpagesës nga të gjithë pjesëmarrësit e palës së përshkruar në kontratë. Depozitimi i fondeve mund të kryhet edhe nga njëri prej personave që janë pala porositëse në rastin tuaj, pjesëmarrëse në kontratën mbi të cilën bazohet pagesa.*

Përmbajtja e kësaj shkrese, parë në panoramën tërësore të ofruar nga dokumentacioni bankar i administruar, krahasuar me rrjedhën e ngjarjeve që kanë pasuar pagesën për blerjen e pasurisë përshkruar nga subjekti i rivlerësimit, dëshmon se vetëm fakti që depozitimi i pagesës në *cash* në sportelin bankar është nënshkruar vetëm nga ai, nuk mund të shërbejë me peshë përcaktuese në proces, për të arritur në përfundimin se subjekti është pronar i gjithë pjesës së pasurisë që i korrespondon kësaj pagese, konkretisht 78% të saj. Gjithashtu, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit dhe znj. Zh., pagesat për blerjen e pasurisë apartament i kanë kryer në përputhje me afatin e përcaktuar në kontratën përkatëse të porosisë<sup>14</sup>, në një vlerësim të arsyeshëm të fakteve, duket e palogjikshme që subjekti i rivlerësimit ndërkohë që ka paguar 78% të vlerës së pasurisë nëpërmjet sistemit bankar në një mënyrë lehtësisht të verifikueshme në çdo formë kontrolli, të ketë regjistruar pasurinë në regjistrat publikë, në pjesë takuese më të vogël, vetëm në 50%.

(vi) Znj. E. Zh., sipas formularit të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, ka aplikuar për regjistrimin e pasurisë “apartament” në regjistrin e pasurive të paluajtshme më datë 24.06.2015, duke kryer edhe pagesën në shumën 88.440 lekë, detyrim që u përkiste të dy bashkëpronarëve. Një veprim i tillë, i kryer në rutinën e veprimeve juridike të ligjshme të bashkëpronarëve kundrejt të drejtave mbi pasurinë e përbashkët, në analogji me faktet e përshkruara në paragrafin (v) më sipër, nëse do të shihej në optikën e vlerësimit të një fakti të vetëm, do të çonte në përfundimin e gabuar se znj. Zh. ishte pronare e 100% të pasurisë.

(vii) Pjesa takuese prej 1/2 e pasurisë “apartament”, është shitur nga znj. E. Zh. te z. I. Ç., babai i subjektit të rivlerësimit, me anë të kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.10.2018, në shumën 40.000 euro, e cila do të paguhej nëpërmjet llogarisë së noterit në Bankën

---

<sup>13</sup> Akt i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj dhe i administruar në cilësinë e provës në seancën gjyqësore të datës 28.09.2023.

<sup>14</sup> Sipas përcaktimeve të nenit 2 të kontratës së porosisë së lidhur më datë 14.05.2013, çmimi i sipërmarrjes së apartamentit objekt kontrate, në shumën 73.528 euro, do të likuidohej në datën e lidhjes së kësaj kontrate. Sipas mandateve bankare, pagesat për likuidimin e plotë të këtij çmimi janë kryer në datat 14 - 15.05.2013.

Kombëtare Tregtare<sup>15</sup>. Më datë 01.11.2018, në llogarinë në euro të znj. Zh. në këtë bankë, ka kaluar shuma 40.000 euro. Pasuria në 1/2 pjesë është regjistruar në emër të z. I. Ç. më datë 17.10.2018. Shuma e përfituar nga shitja e pjesës takuese ka kaluar për çelje depozite më datë 07.12.2018 në të njëjtën bankë dhe ka vazhduar të qëndrojë në llogaritë bankare të znj. Zh., një pjesë e së cilës ka kaluar në depozitë të re më datë 23.01.2020 dhe pjesa tjetër është tërhequr *cash* më datë 24.01.2020. Këto fakte dëshmojnë se shitja e pjesës takuese nga znj. Zh. ka qenë një akt juridik i vërtetë, pasi të ardhurat e përfituara janë gëzuar prej znj. Zh..

32. Bazuar në vlerësimin si më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se pretendimi i Komisioneres Publike është i pabazuar në fakte dhe në ligj, pasi rrethanat e mësipërme janë të mjaftueshme për të krijuar bindjen e plotë se kontributi real i subjektit të rivlerësimit në krijimin e pasurisë “apartament” ka qenë në masën 50% të çmimit të tij, pra në shumën 36.764 euro.
33. Në vijim të sa më sipër dhe në të njëjtën linjë arsyetimi, trupi gjykues analizoi shkakun e ankimit të Komisioneres Publike, lidhur me verifikimin e burimit të krijimit të shumës 36.764 euro, si pagesë e kryer nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e pasurisë “apartament”.
34. Në analizë të pretendimit të Komisioneres Publike se *huanë e marrë nga z. F. H., subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar si burim për krijimin e pasurisë “apartament” në deklaratën e rivlerësimit, për pasojë kjo konsiderohet si mangësi dhe pasaktësi në deklarim, për sa kohë që ekzistenca e kësaj marrëdhënieje vërtetohet me prova të tjera, nga të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ prej Komisionit, trupi gjykues konstatoi si vijon.*

34.1 Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar si burim krijimi për pasurinë apartament, ndër të tjera: *Kontratë kredie bankare nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., në shumën 30.000 euro.*

34.2 Në kërkesën për kredi të datës 25.06.2013, drejtuar Tirana Bank, subjekti i rivlerësimit ka referuar: *[...] kam blerë një apartament në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, 91,91 m<sup>2</sup>, kosto totale 73.528 euro. Nga këto kam paguar të gjitha këstet sipas kontratës së porosisë me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, me para të marra borxh, sipas kontratës së borxhit me z. F. H. në shumën 30.000 euro. Bashkëlidhur kërkesës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kontratën e huasë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.06.2013, me objekt dhënie hua e një shume të hollash prej 30.000 eurosh, për nevoja familjare, mes z. F. H. huadhënës dhe z. Arbër Çela huamarrës, për një afat tremujor deri në lëvrimin e një kredie që do të merrej nga huamarrësi pranë Tirana Bank.*

---

<sup>15</sup> *Kontrata e përcjellë në Komision nga zyra e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Veri, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 09.12.2020.*

34.3 Me anë të kontratës së kredisë bankare hipotekore nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.09.2013, Tirana Bank, dega Lushnje, i ka dhënë z. Arbër Çela, z. I. dhe znj. P. Ç. kredinë në shumën 30.000 euro, e cila do të përdoret për blerje shtëpie.

34.4 Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga Tirana Bank<sup>16</sup>, kredia është disbursuar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në datën 27.09.2013, në shumën 30.000 euro. Në datën 30.09.2013, shuma 30.000 euro është transferuar në llogarinë e z. F. H., individ, në të njëjtën bankë, me përshkrimin: “Kthim borxhi”. Po në këtë datë, z. F. H. ka tërhequr shumën e plotë prej 30.000 eurosh.

35. Në përfundim të kontrollit dhe vlerësimit lidhur me huanë në shumën 30.000 euro, Komisioni ka vlerësuar se për sa kohë u provua se z. F. H. kishte likuiditete të disponueshme në llogaritë e tij bankare, si dhe aktivitet tregtar e kontrata pune, u gjetën gjurmë të ekzistencës së kësaj marrëdhënieje ndër vite, ajo nuk mund të ketë shërbyer si një mjet për të justifikuar mungesë të burimeve të ligjshme, deklaram të rremë, fshehje pasurie apo situatë konflikti interesi, nuk përbën deklaram të pamjaftueshëm në kuptim të parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
36. Komisionerja Publike, në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj, ka parashtruar se huaja nuk rezulton e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burim për krijimin e pasurisë “apartament” në deklaratën periodike të interesave të vitit 2013, në deklaratën e rivlerësimit apo në përgjigjet e pasqyruara në procesverbalin e vitit 2014 të mbajtur në ILDKPKI, edhe pse kjo marrëdhënie rezulton e provuar nga aktet në dosjen e rivlerësimit, duke kryer kështu deklaram të pasaktë.
37. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, për deklarimin e huasë si një nga burimet e krijimit të pasurisë objekt kontrolli, ka parashtruar të njëjtin qëndrim që ka mbajtur edhe në përgjigje të barrës së provës së kaluar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, se huaja e marrë nga z. F. H. nuk është deklaruar si burim për krijimin e pasurisë “apartament”, për shkak të faktit se ajo është përdorur vetëm për rreth 3 muaj, derisa u lëvrua dhe disbursua kredia nga Tirana Bank dhe duke qenë se ky veprim ka filluar dhe përfunduar brenda të njëjtit vit deklarimi, nuk përmbushte kriterin ligjor si hua me detyrim deklarimi nga ana e tij pranë ILDKPKI-së. Kredia është marrë me qëllim shlyerjen e shumës marrë z. F. H., ajo është me afat 15-vjeçar dhe vazhdon të shlyhet edhe sot prej tij.
38. Trupi gjykues vëren se neni D i Aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar se subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë me saktësi, ose plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur, në funksion të konfirmimit në detyrë, sikurse edhe me detyrimet ligjore të tij si zyrtar deklarues/subjekt i ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”). Plotësimi me saktësi dhe vërtetësi i deklaratës së rivlerësimit është detyrim i përcaktuar edhe në

---

<sup>16</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 06.06.2022.

kuadrin ligjor dhe nënligjor të procesit të rivlerësimit, konkretisht ligji nr. 84/2016 dhe udhëzimi nr. {\*\*\*} prot., datë 10.10.2016, i ILDKPKI-së. Nga dokumentacioni i administruar, trupi gjykues konstatoi se deklarimi në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, se kjo pasuri është krijuar me burime nga kredia, huaja nga prindërit dhe kursimet, nuk është i plotë, pasi në kundërshtim me parashikimet ligjore të sipërcituara, nuk përfshin burimin e përdorur në momentin e krijimit të pasurisë, huanë në shumën 30.000 euro, e marrë nga z. F. H., për pagesën e pjesës takuese të pasurisë “apartament”. Në këto kushte, deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit provohet se nuk është i plotë, parë në raport dhe me faktin se huaja nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi as në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013.

39. Në konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë të pasurisë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit sa i përket mosdeklarimit të huasë së marrë nga z. F. H. në shumën 30.000 euro, si burim krijimi për pasurinë apartament, duke u gjendur në kundërshtim me përcaktimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
40. Lidhur me verifikimin e burimit të krijimit të shumës 30.000 euro, dhënë hua subjektit të rivlerësimit nga z. F. H., në vendimin e Komisionit<sup>17</sup> objekt shqyrtimi, është konkluduar se:  
*Trupi gjykues arsyeton se nga tërësia e provave të mbledhura gjatë hetimit, rezulton se nga provat direkte dhe ato indirekte, z. F. H. ka pasur mundësi financiare të japë hua në shumën 30.000 euro për një afat të shkurtër kohor dhe se provohet se shuma e kredisë së disbursuar nga Tirana Bank është përdorur për shlyerjen e huasë z. F. H., me transfertë bankare. Z. F. H. ka pasur qarkullim të likuiditeteve, e përderisa shuma e dhënë hua është kthyer brenda vitit ushtrimor financiar, edhe pagimi i taksave e tatimeve bëhet në fund të vitit ushtrimor, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi subjekti në zbatim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në vlerësim të trupit gjykues, huadhënia rezulton e dokumentuar/provuar dhe bindëse. Subjekti i rivlerësimit ka përmbushur detyrimin e nenit 32, pika 4, duke provuar marrëdhënien e huamarrjes dhe duke treguar burimet e huadhënësit. Nga vështrimi i përgjithshëm i gjendjes së likuiditeteve të huadhënësit, rezultojnë të ardhura në sistemin bankar, rezulton qarkullim në aktivitetin e biznesit si person fizik, po ashtu edhe kontrata financiare. Për sa kohë që tatimi paguhet në fund të vitit ushtrimor dhe marrëdhënia e huasë ka ndodhur për një periudhë të shkurtër brenda vitit ushtrimor, të ardhurat/likuiditetet e huadhënësit përbëjnë një burim të ligjshëm në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016.*
41. Ndryshe nga ky qëndrim i Komisionit, Komisionerja Publike ka pretenduar në ankim dhe në parashtrimet para Kolegjit, se z. F. H., si person tjetër i lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk kishte mundësi për të krijuar me burime të ligjshme shumën prej 30.000 eurosh, dhënë hua subjektit të rivlerësimit, pasi për burimet e deklaruara të kësaj huaje, ka rezultuar:

---

<sup>17</sup> Paragrafi “d”, faqe 17 e vendimit të Komisionit.

a) Lidhur me të ardhurat nga kontrata e premtimit për shitje, datë 25.01.2013, ndërmjet huadhënësit F. H. dhe z. A. H. për shitjen e dy trojeve në pronësi të tij, nuk mund konsiderohen si të ardhura të ligjshme, pasi:

i. Nuk ka të dhëna, që kjo shumë është përdorur si burim për huanë, kontrata nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit të parë, por është vënë në dispozicion nga ky i fundit vetëm më vonë gjatë hetimit administrativ.

ii. Sipas përgjigjes së Ministrisë së Drejtësisë nr. {\*\*\*} prot., datë 31.08.2022, rezulton se ky akt nuk është i regjistruar në regjistrin noterial, si dhe mungon akti i revokimit që vë në dyshim vërtetësinë e kësaj marrëdhënieje.

iii. Nga analiza e kontratës, rezulton se palët e përfshira kanë nënshkruar si individë dhe jo si subjekte biznesi. Sipas përgjigjes së Drejtorisë Rajonale Tatimore me nr. {\*\*\*} prot., datë 24.10.2022, ka rezultuar se transaksionet e përmendura në kontratën e premtimit të shitjes nuk janë pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2013, në gjendjet/lëvizjet e *cash*-it ose librat e shitjes së subjektit tregtar, të depozituara nga ky i fundit në sistemin informatik tatimor.

b) Lidhur me të ardhurat nga aktiviteti i biznesit, ka rezultuar se nga analizat e pasqyrave financiare të personit fizik “F. H.”, për periudhën 2008-2013, duket se fitimi është akumuluar në zërin “fitim i pashpërndarë”, si pjesë e kapitalit neto të vitit 2010 dhe rrjedhimisht nuk rezultojnë shuma të tërhequra/në dispozicion të pronarit. Shuma e akumuluar e fitimit nuk rezulton në *cash në arkë*, por është reflektuar në një rritje të aksioneve/inventarit të biznesit.

42. Subjekti i rivlerësimit prapësoi këtë qëndrim të Komisioneres Publike, duke pretenduar se huaja në shumën prej 30.000 eurosh, rrjedh nga burime të ligjshme, duke argumentuar në mënyrë të përmbledhur se:

a) Kontrata premtim shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.01.2013, ka si objekt blerjen e truallit në pronësi të z. F. H. nga z. A. H., të dy në cilësinë e individit dhe jo të subjektit tregtar tatimpagues. Meqenëse natyra e inventarit të ndodhur mbi truallin, objekt i kontratës së shitblerjes, ishte e tillë që nuk mund të transferohej diku tjetër, ky inventar është marrë në posedim nga pala premtuese e blerjes, e cila ka paguar si garanci shumën prej 4.500.000 lekësh për këtë sasi malli. Për z. F. H. nuk kanë lindur detyrime tatimore të çdo lloji, në momentin e arkëtimit të kësaj shume, kjo pasi në momentin e transferimit të pronësisë së mallit, do të lindte detyrimi për lëshimin e faturës tatimore apo për nënshkrimin e transferimit të veprimtarisë ekonomike. Pretendimi se kontrata e sipërcituar nuk është regjistruar në regjistrin noterial, nuk është i bazuar në ligj, pasi kontrata premtim shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.01.2013, është lidhur përpara krijimit të regjistrit elektronik noterial, vërtetuar edhe nga shkresa e Ministrisë së Drejtësisë.

b) Nga të dhënat e përcjella nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, rezulton e provuar se personi fizik “F. H.” ka pasur qarkullim financiar dhe fitim të konsiderueshëm në vite.

c) Vetëm nga llogaritë personale rrjedhëse në lekë, rezulton e provuar se z. F. H. ka tërhequr *cash* shuma të cilat tejkalojnë shumën e dhënë hua.



43. Komisionerja Publike, pasi u njoh me shpjegimet dhe qëndrimin e mbajtur nga subjekti i rivlerësimit, si dhe me aktet e paraqitura prej tij dhe të administruara si provë gjatë gjykimit në Kolegj, në konkluzionet përfundimtare parashtrori se akti i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit – shkresa e Ministrisë së Drejtësisë nr. {\*\*\*} prot., datë 22.09.2023, mbi informacionin lidhur me datën kur ka filluar punë Regjistri Noterial Shqiptar, provon prapësimet dhe pretendimet e tij mbi arsyet e mospasqyrimin të kontratës premtim shitje, datë 25.01.2013, në këtë regjistër. Nga ana tjetër, në vlerësimin e Komisioneres Publike, edhe gjatë shqyrtimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë provë të re për të provuar burimin e ligjshëm të huasë prej 30.000 eurosh, dhënë nga z. F. H., si nga të ardhurat e biznesit, ashtu dhe nga ato personale, duke konfirmuar qëndrimin e mbajtur në ankim dhe në parashtrime gjatë gjykimit në Kolegj.
44. Trupi gjykues, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, për sa i përket huadhënësit F. H., pasi u njoh me kërkimet përfundimtare të Komisioneres Publike, me shpjegimet dhe prapësimet e dhëna lidhur me to nga subjekti i rivlerësimit, analizoi sa vijon.
- Trupi gjykues vëren se nga analiza e kontratës premtim shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.01.2013, që përbën bazën e shkakut të ankimit, rezulton se marrëdhënia juridike është krijuar mes palëve të identifikuara si individë dhe jo ndërmjet një individi dhe një subjekti tregtar tatimpagues. Nëpërmjet kësaj kontrate, personi tjetër i lidhur, individi F. H. ka shprehur vullnetin për kalimin në posedim të individit A. H., përveç dy trojeve, edhe të stokut/inventarit të vendosur në këto pasuri, përkundrejt parapagimit/dhënies si garanci të shumës prej 4.500.000 lekësh. Rëndësi në këtë analizë merr fakti se pasuritë objekt i kontratës, konkretisht trualli me sipërfaqe totale 3.750 m<sup>2</sup>, mbi të cilin ndodhet një ndërtesë 60 m<sup>2</sup>, si dhe trualli me sipërfaqe 1.900 m<sup>2</sup> ishin pasuri në pronësi të individit F. H., duke mos disponuar për shitjen e pasurisë së subjektit tregtar, personit fizik “F. H.”. Sa i përket stokut/inventarit, i cili ishte pasuri e personit fizik, kontrata e premtim shitjes njihete mundësinë për formalizimin e shitjes në të ardhmen të stokut/inventarit, brenda afatit të përcaktuar në kontratë, në përputhje me legjislacionin civil. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues çmoi se personi tjetër i lidhur, z. F. H., për shumën 4.500.000 lekë, të përfituar për shkak të lidhjes së kontratës premtim shitje, në momentin e pagesës së saj, nuk mbartte detyrimin për lëshimin e një fature tatimore për dhënien në posedim të stokut/inventarit z. A. H. dhe, për rrjedhojë, nuk mbartte as përgjegjësinë për pagimin e detyrimit tatimor sipas legjislacionit fiskal në fuqi.
- Në konkluzion, në vlerësim të trupit gjykues, shuma prej 4.500.000 lekësh, e përfituar nga z. F. H. si rezultat i lidhjes së kontratës premtim shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.01.2013, është e ardhur e ligjshme e tij, e cila plotëson kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
45. Pavarësisht se shuma prej 4.500.000 lekësh mbulon vlerën e huasë prej 30.000 eurosh, trupi gjykues vlerësoi edhe nëse personi tjetër i lidhur, z. F. H., kishte mundësi që vetëm me likuiditetet e tij, të mbulonte me burime financiare të ligjshme shumën e dhënë hua.
- Në funksion të këtij arsyesimi, trupi gjykues mori në analizë të gjithë informacionin e përcjellë në Komision nga institucionet bankare, lidhur me likuiditetet e gjendura në to, të cilat i përkisnin

individit z. F. H.. Nga ky vlerësim, rezultoi se në një periudhë të afërt kohore, paraprirë dhënies së huasë, në vitet 2012-2013, z. F. H. ka tërhequr në *cash*, vetëm nga një prej llogarive personale pranë Raiffeissen Bank, shumën prej 3.687.789 lekësh, e cila mbulon shumën e huasë. Tërheqjet nga banka rezultuan me të ardhura të ligjshme, të analizuara këto të ndërlidhura me të dhënat që rezultojnë nga veprimtaria tregtare në këto vite e personit fizik “F. H.”, bazuar në analizën si vijon. Nga kronologjia e veprimeve të kryera në këtë llogari, rezulton se z. F. H. në vitin 2012, ka përdorur edhe një *overdraft*. Nga bilanci i vitit 2012, rezulton që z. F. H. ka pasur një qarkullim vjetor në vlerën 2.930.140 lekë, që do të thotë gjatë këtij viti, personi fizik “F. H.” ka shitur dhe ka arkëtuar këtë vlerë. Gjithashtu, me këtë qarkullim vjetor, rezulton se ka përballuar detyrimet dhe shpenzimet e personit fizik për vitin 2012, pa pasur nevojë të përdorimit të *overdraft*-it të tërhequr prej tij gjatë vitit 2012, pra duke e pasur atë të lirë. Bazuar në këtë analizë, trupi gjykues vlerësoi se shuma prej 3.687.789 lekësh, që shtetasi F. H. ka tërhequr nga *overdraft*-i, konsiderohet e ardhur e ligjshme, e cila mund të jetë përdorur për dhënien e huasë subjektit të rivlerësimit Arbër Çela. Po kështu, z. F. H., nga llogaria individuale në ProCredit Bank, ka tërhequr shumat 807.700 lekë për periudhën qershor 2010 deri në dhjetor 2011. Në total, rezulton se z. F. H. ka tërhequr deri në momentin e dhënies së huasë subjektit të rivlerësimit, shumën 4.495.489 lekë. Mbështetur në këto të dhëna të analizuara si më sipër, duket se z. F. H. ka disponuar shuma parash për dhënien e huasë, pa përfshirë këtu tërheqjet e kryera në Raiffeissen Bank, në një periudhë më të largët, 2005-2009, në shumën 7.171.658 lekë.

Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues thekson se analiza në këtë paragraf, është bërë për një vlerësim të përgjithshëm të mundësisë financiare të personit tjetër të lidhur, por ajo nuk është përcaktuese për justifikimin me të ardhura të ligjshme të shumës prej 30 mijë eurosh, të dhënë hua nga z. F. H., për sa kohë që u provua në kuadër të këtij gjykimi, ligjshmëria e saj bazuar në kontratën e premtim shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.01.2013, të lidhur ndërmjet këtij të fundit dhe z. A. H., në cilësinë e individit dhe jo të subjektit tregtar tatimpagues.

46. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se huadhënësi kishte mundësi për të financuar krejtësisht shumën prej 30.000 eurosh me të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe, për pasojë, ajo do të konsiderohet se e kalon testin e parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
47. Në konsideratë të konkluzionit të mësipërm, duke renditur shumën prej 30.000 eurosh në burimet e përdorura për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioneri Publik, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi të justifikonte me burime të ligjshme pagesën e pjesës takuese prej 50% të pasurisë “apartament me sipërfaqe 91,91 m<sup>2</sup>”, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në përputhje me nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
48. Sa i përket dyshimit të paraqitur në ankim për fshehje të pasurisë “apartament” nëpërmjet bashkëpronares, znj. E. Zh., dyshim i bazuar në gjetjet për kontributin real të subjektit të rivlerësimit për këtë pasuri, si dhe të rrethanave në të cilat ajo është krijuar, përdorur dhe shitur, të

cilat, sipas Komisioneres Publike, kanë qenë të pazakonta, trupit gjykues i rezultoi se, gjatë gjykimit në Kolegj, referuar paragrafit 1.4 të konkluzioneve përfundimtare, Komisionerja Publike është tërhequr nga ky dyshim<sup>18</sup>. Ky konkluzion i Komisioneres Publike, në vlerësimin e trupit gjykues, bazuar në nenin 3, pika 14 dhe nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, e bën të panevojshëm verifikimin e mundësisë së znj. E. Zh. për të përballuar me burime financiare të ligjshme, pagimin e 50% të çmimit të këtij apartamenti, pasi ajo nuk mund të kualifikohet në cilësinë e personit tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit. Pavarësisht sa më sipër, me qëllim shterimin e pretendimeve, në funksion të konkluzioneve përfundimtare të Komisioneres Publike, edhe pse një vlerësim i tillë konsiderohet në kapërcim të objektit të kontrollit të pasurisë sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 e vijues të ligjit nr. 84/2016, si dhe standardeve të zbatuara në Kolegj, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, vlerësoi mundësinë e bashkinvestitores/bashkëpronares, znj. E. Zh., për të paguar me burime të ligjshme financiare shumën prej 36.764 eurosh.

49. Komisioni, në vendim<sup>19</sup>, ka arsyetuar se: *[...] shtetasja E. Zh. ka pasur mundësi financiare të kursejë të ardhura me burim nga pagat (duke përfshirë të ardhurat nga punësimi që prej vitit 2008 në shoqërinë “{\*\*\*}” e pas zbritjes së shpenzimeve jetike) deri në shumën 26.000 euro [nga e cila, shuma prej 10.285 eurosh ka qenë e investuar në depozita kursimi, tërhequr ditën që është kryer pagesa në shoqërinë e ndërimit].*
50. Në kundërshtim të konkluzionit të mësipërm, në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj, Komisionerja Publike ka parashtruar pretendimet, të cilat u analizuan nga trupi gjykues si më poshtë.
51. Në shqyrtim të pretendimit se: *për qëllime të këtij procesi, për znj. E. Zh., të vetmet të ardhura të ligjshme që plotësojnë standardet e parashikuara në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, janë ato të konfirmuara nga ISSh-ja, për periudhën 2008-2013, të cilat nuk mjaftojnë për të mbuluar shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë dhe pagesën e pjesës 50% të vlerës së pasurisë, nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi si vijon.*
- 51.1 Në deklaratën e rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kontributi i znj. E. Zh. prej 50% të çmimit të blerjes së apartamentit, ka si burim të ardhurat e saj nga puna, si dhe të ardhura të përfituara nga hua të marra prej saj.

---

<sup>18</sup> Sipas paragrafit 1.4, faqe 3 e konkluzioneve përfundimtare, të depozituara në datën 26.10.2023: “Në përfundim, në vlerësimin e Komisionerit Publik, për pasurinë “apartament me sipërfaqe 91,91 m<sup>2</sup>”, në referencë të nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka mungesë burimi të ligjshëm për krijimin e të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë, duke u gjendur në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016”.

<sup>19</sup> Faqe 15 e vendimit të Komisionit.

**51.2** Nga hetimi i kryer nga Komisioni, sipas të dhënave të përcjella nga punëdhënësi i znj. Zh., institucionet bankare dhe ISSh-ja, rezultuan këto të dhëna lidhur me të ardhurat e përfituara prej saj, për periudhën nëntor 2008 - maj 2013:

- Sipas të dhënave të vërtetimit zyrtar të Ambasadës Turke: të ardhura neto nga paga në shumën totale 28.770 eurosh, ose 3.999.032 lekë, për periudhën 31.08.2009 - 01.05.2013.

- Sipas të dhënave të sistemit bankar: të ardhura neto nga paga në shumën totale 1.832.419 lekë, për periudhat nëntor 2008 - korrik 2009 dhe shkurt 2012 - maj 2013.

Në total, për periudhën nëntor 2008- maj 2013, të ardhurat janë në shumën 4.258.231 lekë.

- Sipas të dhënave të ISSh-së: të ardhura nga paga, mbi të cilat janë paguar kontributet në shumën totale 1.185.329 lekë, për periudhën nëntor 2008 - maj 2013.

**51.3** Me shkresën e datës 18.11.2022, konsulli tregtar i Ambasadës Turke, znj. P. O., ka informuar znj. Zh. se për periudhën gusht 2009 - shkurt 2012, paga e saj për pozicionin e stafit administrativ në misionin diplomatik, i është paguar në *cash*, ndërsa për periudhën mars 2013 - dhjetor 2014, paga i është kaluar në llogarinë bankare personale. Në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat nga pagat, në këtë shkresë është sqaruar se ato janë bërë nga Ministria e tyre në Turqi, në Autoritetin Tatimor Turk.

**52.** Në analizë të kësaj situate faktike, Komisionerja Publike në ankim dhe në parashtrimet gjatë gjyqimit në Kolegj, pretendoi se për të ardhurat e ligjshme të znj. Zh. nga punësimi në Ambasadën Turke, detyrimet tatimore përkatëse duhet të ishin paguar në shtetin ku kryhet puna, në Republikën e Shqipërisë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ndonjë dokument që të vërtetojë pretendimin e tij, se një pjesë e detyrimit tatimor në lidhje me të ardhurat e znj. Zh. ishin paguar në shtetin turk. Sipas Komisioneres Publike, të vetmet të ardhura të ligjshme që plotësojnë standardet e parashikuara në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, janë ato të konfirmuara nga ISSh-ja, të cilat nuk mjaftojnë për të mbuluar shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë për znj. Zh., si dhe investimin në pasurinë apartament, për pjesën takuese 50% të vlerës së pasurisë.

**53.** Subjekti i rivlerësimit, lidhur me qëndrimin e Komisioneres Publike të përshkruar më sipër, gjatë gjyqimit në Kolegj, prapësoi se znj. Zh. ka realizuar të ardhura nga paga, për periudhën gusht 2009 - maj 2013, në total në shumën prej 28.750 eurosh, të cilat janë të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Për të provuar pretendimin e tij mbi ligjshmërinë e të ardhurave të znj. Zh., subjekti i rivlerësimit, gjatë gjyqimit në Kolegj, paraqiti dokumentacionin vërtetues, i cili përmbushte kriteret ligjore nga pikëpamja formale, e konkretisht:

(i) Vërtetimi nr. {\*\*\*} i Drejtorisë së Përgjithshme të Personelit, të Ministrisë së Tregtisë së Republikës së Turqisë, sipas të cilit: [...] *taksa mbi të ardhurat për E. Zh., e bazuar në kontratën si eksperte lokale, e specializuar në përfaqësinë e ministrisë sonë, në Zyrën e Tregtisë së Jashtme pranë Ambasadës Turke Tiranë, gjatë periudhës 01.02.2010 - 31.12.2014, është paguar në Turqi.*

(ii) Vërtetimi nr. {\*\*\*} i Drejtorisë së Përgjithshme të Personelit, të Ministrisë së Tregtisë së Republikës së Turqisë, sipas të cilit taksa mbi të ardhurat e përfituara nga znj. E. Zh., në detyrën e sekretares në Zyrën e Tregtisë së Jashtme, pranë Ambasadës Turke në Tiranë, për periudhën 31.08.2009 - 31.01.2010, është paguar në Turqi.

54. Komisionerja Publike, në konkluzionet përfundimtare, pasi u njoh me shpjegimet dhe qëndrimin e mbajtur nga subjekti i rivlerësimit si më sipër, parashtrori qëndrimin e saj, duke konkluduar se aktet e paraqitura nga subjekti gjatë gjykimit në Kolegj, mbi pagesën e detyrimeve tatimore në shtetin turk për znj. Zh., nuk provojnë të ardhurat e pretenduara në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pasi në to nuk specifikohet vlera e tatimit të paguar për periudhën 2009-2014.
55. Në analizë të panoramës së ofruar nga situata faktike e pasqyruar si më sipër, në raport me pretendimet e palëve në këtë gjykim, sa i takon vlerësimit të ligjshmërisë së të ardhurave të përfituara nga znj. Zh., në kuadër të standardit të vendosur nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues vlerësoi se detyrimet tatimore janë paguar nga punëdhënësi Ambada e Republikës Turke, pranë autoriteteve shtetërore përkatëse në shtetin turk, ashtu siç rezultoi nga vërtetimet e përcjella nga Drejtoria e Përgjithshme e Personelit, të Ministrisë së Tregtisë së Republikës së Turqisë. Trupi gjykues vëren se pagesa në shtetin turk e tatimeve mbi pagën për znj. Zh., si punonjëse në Ambasadën Turke në Shqipëri, mbështetet në marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, “Për shmangien e tatimeve të dyfishta lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin”, ratifikuar nga shteti shqiptar me anë të ligjit nr. 7858, datë 21.09.1994<sup>20</sup>.
56. Sa i përket pretendimit të Komisioneres Publike, se nga vërtetimet e Ministrisë së Tregtisë të Turqisë, nuk përcaktohet vlera e tatimit të paguar në shtetin turk, trupi gjykues vlerësoi se kjo çështje nuk është relevante, për sa kohë që punëdhënësi i znj. Zh. është një institucion shtetëror në Republikën e Turqisë dhe përlllogaritja e tatimit/taksës së paguar është bërë në përputhje me legjislacionin e atij shteti.
- Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se të ardhurat nga pagat, të përfituara nga znj. Zh. si punonjëse pranë Ambasadës së Republikës Turke në Shqipëri, referuar vërtetimeve përkatëse të pagës, duhet të merren në konsideratë në analizën financiare, në kuadër të vlerësimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme, për krijimin e pjesës takuese të znj. Zh., në shumën 36.764 euro, në pasurinë “apartament”, si të ardhura që nuk cenojnë standardin e të ardhurave të ligjshme, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- Në kuadër të këtij vlerësimi, trupi gjykues mbajti gjithashtu në konsideratë se: (i) derdhjet e pagës janë kryer në tërësinë e tyre, në periudhën që ato janë kaluar nëpërmjet sistemit bankar, në të

---

<sup>20</sup> Marrëveshja është botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 15, datë 10.11.1994, f. 684 dhe nga Republika e Turqisë në Fletoren Zyrtare nr. 22778, datë 05.10.1996. Marrëveshja i ka filluar efektet që nga data 01.01.1997.

njëjtën masë me atë të referuar në vërtetimin e pagës së lëshuar nga punëdhënësi; (ii) punëdhënësi ka qenë një përfaqësi diplomatike, e cila e ka vënë në dijeni znj. Zh. se detyrimet tatimore, (mbi ato që vërtetohet se janë paguar mbi pagën minimale në Shqipëri), janë paguar në shtetin turk; (iii) znj. Zh. ka pasur një marrëdhënie të qëndrueshme punësimi me punëdhënësin, Ambasadën e Republikës së Turqisë në Shqipëri; (iv) nga historiku i punësimit të saj, znj. Zh. nuk ka qenë asnjëherë subjekt deklarimi i interesave privatë dhe pasurisë dhe as person i lidhur me ndonjë zyrtar deklarues, për pasojë ka qenë në marrëdhënie mirëbesimi në raport me sjelljen e palës punëdhënëse kundrejt detyrimit të kësaj të fundit për pagimin e detyrimeve tatimore.

57. Trupi gjykues, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, verifikoi se për periudhën 2009 - maj 2013, znj. Zh. ka realizuar të ardhura *neto* në shumën totale prej 28.770 eurosh. Referuar analizës financiare të kryer në Kolegj, për periudhën në fjalë, rezultoi se znj. Zh. kishte mundësi që nga të ardhurat e ligjshme nga pagat, të paguante shumën prej 18.764 eurosh, si pjesë e pagesës për blerjen e 50% të pasurisë “apartament”, pasi pjesa tjetër është përballuar nga huatë e marra prej saj për këtë qëllim.
58. Komisionerja Publike ka pretenduar se: *për sa u përket dy huave, në shumat 8.000 euro dhe 10.000 euro, të pretenduara se janë marrë nga znj. E. Zh. për blerjen e pjesës së saj takuese të apartamentit, vlerësohet se ekzistenca e tyre mbetet e diskutueshme, por edhe nëse merren në konsideratë, subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion burimin financiar të huadhënësve për shumat në fjalë. Sa i përket këtij pretendimi, trupi gjykues analizoi si vijon.*
59. Komisioni, në vendim<sup>21</sup>, ka arsyetuar se: “Lidhur me kontratën e huasë për vlerën 8.000 euro të vitit 2017, trupi gjykues vlerëson se kjo hua është deklaruar si burim në deklaratën e rivlerësimit dhe se kanë rezultuar gjurmë të mëvonshme në lëvizjet e llogarisë bankare në Bankën Kombëtare Tregtare, lidhur me shlyerje të pjesshme. Lidhur me kontratën e huasë për vlerën 10.000 euro, të deklaruar gjatë hetimit administrativ nga Komisioni dhe të dokumentuar me deklaratë noteriale të vitit 2019, trupi gjykues vlerëson se ajo është deklaruar vetëm gjatë hetimit standard dhe deklarata e vitit 2019 nuk përbën ndonjë vlerë provuese për këtë proces”.
60. Komisionerja Publike, në ankim, parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare gjatë gjykimit në Kolegj, ka pretenduar se për sa i përket huasë së pretenduar në shumën 8.000 euro, marrë nga znj. E. Zh., prej znj. B. O., vërtetimi “Për bazën e vlerësuar” nr. {\*\*\*} prot., datë 15.02.2022, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për periudhën maj 2012-2013, i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore të datës 28.09.2023, mbi burimet financiare të znj. B. O., nuk provon mundësinë e saj për të mbuluar shumën e deklaruar të dhënë hua. Aktet e vëna në dispozicion nga subjekti mbi të ardhurat e ligjshme të prindërve të znj. B. O., në vlerësimin e

---

<sup>21</sup> Faqe 15 e vendimit të Komisionit.

Komisioneres Publike, nuk provojnë mundësinë e vetë znj. B. O. për dhënien e huasë në shumën 8.000 euro.

Për sa i përket huasë tjetër të pretenduar, në shumën 10.000 euro, marrë nga znj. E. Zh. prej znj. K. Zh., në vlerësimin e Komisioneres Publike: (i) kjo marrëdhënie huaje nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit dhe as në procesverbalin mbajtur në ILDKPKI, në datën 20.10.2014; (ii) nuk provohet marrëdhënia e huasë me akte të kohës; (iii) nga lëvizjet e llogarive bankare të z. H. Sh., nuk evidentohet ndonjë transaksion që të lidhet me marrëdhënien e pretenduar të huasë.

61. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, i prapësoi pretendimet e Komisioneres Publike, duke pretenduar se:

*i.* Për huanë e marrë nga znj. Zh. prej znj. B. O., në kushtet kur burimi i fondeve është deklaruar në momentin e kryerjes së pagesës “kursime + huamarrje”, si dhe është paraqitur dokumentacion në dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit, kjo shumë e marrë hua duhet të konsiderohet si një nga burimet financiare për pagesën e pjesës takuese të saj në blerjen e apartamentit. Përveç të ardhurave nga punësimi, znj. O. ka pasur dhe të ardhura të tjera familjare, të cilat janë më se të mjaftueshme për justifikimin dhe mbulimin e shumës së dhënë hua prej 8.000 eurosh.

*ii.* Për huanë e marrë nga znj. Zh. prej znj. K. Zh., në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit, kjo marrëdhënie nuk ishte formalizuar, prandaj nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në këtë deklaratë, si një nga burimet e krijimit të pjesës takuese të bashkëpronësisë së znj. E. Zh.. Të ardhurat familjare të znj. K. Zh. kanë qenë të mjaftueshme për të dhënë huanë të kushërira e saj, znj. E. Zh., shumën 10.000 euro.

62. Trupi gjykues, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, për sa u përket huadhënësive, znj. B. O. dhe znj. K. Zh., pasi u njoh me kërkimet përfundimtare të Komisioneres Publike, me shpjegimet dhe prapësimet e dhëna lidhur me to nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pasi administroi në cilësinë e provës aktet e sjella prej tij në mbështetje të këtyre prapësimeve, analizoi sa vijon.

63. Në vijim të qëndrimit të mbajtur nga trupi gjykues në paragrafin 48 të këtij vendimi, për verifikimin e mundësisë për justifikimin me burime të ligjshme të shumave të dhëna hua nga personat e tjerë të lidhur, znj. E. Zh., kur as kjo vetë nuk është person i lidhur apo tjetër i lidhur me subjektin Arbër Çela, trupi gjykues mbajti në konsideratë se për znj. B. O. dhe znj. K. Zh. nuk mund të gjenin zbatim të plotë standardet e aplikuara nga Kolegji sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për huatë të cilat janë dhënë drejtpërdrejt nga personat e tjerë të lidhur subjekteve të rivlerësimit apo personave të lidhur me ta.

64. Për huanë e marrë në shumën prej 8.000 eurosh, nga znj. Zh. prej znj. B. O., vërtetuar me deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.01.2017, trupi gjykues vëren se në rastin

e analizës për të vërtetuar mundësinë financiare të huadhënësës, rezultojnë të ardhura të dokumentuara të krijuara prej saj dhe familjes së saj, për periudhën shtator 2009 - maj 2013:

*i.* Të ardhura nga puna e znj. B. O., në shumën totale prej 401.659 lekësh, sipas të dhënave të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 15.02.2022, “Vërtetim për bazën e vlerësuar”, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

*ii.* Të ardhura nga aktiviteti “Shërbime dekorative” i personit fizik “{\*\*\*}” (nëna e znj. B. O.), në shumën 1.900.000 lekë. Referuar shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 27.09.2023, të Bashkisë Shkodër, provohet sa ka qenë qarkullimi vjetor për vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013 për personin fizik “{\*\*\*}”. Bashkëlidhur kësaj shkrese, janë përcjellë edhe deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor të personit fizik {\*\*\*} për vitet e sipërcituara. Sipas kësaj shkrese, qarkullimi vjetor në vitet 2012-2013 për këtë person fizik, ka qenë i deklaruar në vlerën 2.500.000 lekë. Në këto kushte, me qëllim vlerësimin e burimeve të ligjshme të familjes së znj. B. O., trupi gjykues mori në analizë të dhënat bankare lidhur me personin fizik “{\*\*\*}”. Nga këto të dhëna, rezultoi se për periudhën 18.01.2012 - prill 2013, në llogarinë bankare të personit fizik me nr. {\*\*\*}, në Bankën e Bashkuar të Shqipërisë, janë kredituar 2.179.661 lekë [brenda vlerës së deklaruar si qarkullim vjetor në këto vite], me përshkrim *likuidim faturash* për shërbimet e ofruara nga subjekti tregtar. Nga të dhënat e së njëjtës llogari bankare, identifikohen pagesa të rregullta të detyrimeve tatimore nga personi fizik, konkretisht më datë 28.03.2012, ka paguar tatimin mbi biznesin e vogël në shumën 42.875 lekë e po kështu, më datë 28.03.2013, ka paguar tatimin mbi biznesin e vogël në shumën 51.910 lekë. Gjatë kësaj periudhe, nga kjo llogari është tërhequr shuma totale prej 1.900.000 lekësh, nga z. Sh. O., babai i znj. B. O.. Në kushtet kur nga llogaria bankare në fjalë, e cila i përket personit fizik, vërtetohet qarkullimi real i realizuar prej tij në periudhën e afërt pararendëse të dhënies së huasë, 2012 - prill 2013, si dhe pagesa e detyrimeve tatimore, trupi gjykues arriti në përfundimin se shuma e tërhequr nga z. Sh. O., konsiderohet e ardhur e ligjshme e realizuar nga aktiviteti tregtar i personit fizik “{\*\*\*}”, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

*iii.* Të ardhurat e përfituara nga z. Sh. O., si rezultat i kontratës së qirasë së pasurisë së paluajtshme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.09.2009, e lidhur mes qiradhënësve B. O. e Sh. O. dhe qiramarrësit A. H.. Sipas përcaktimeve kontraktore, qiradhënësit japin me qira një ndërtesë, me afat 5-vjeçar, kundrejt vlerës së qirasë prej 20.000 lekësh/muaj. Në kontratë janë përcaktuar qartësisht detyrat e qiramarrësit, ndër të cilat edhe pagimi i detyrimeve tatimore ndaj shtetit. Në këto kushte, si e ardhur neto e përfituar nga z. Sh. O., u përlllogarit vlera prej 10.000 lekësh/muaj si njëri nga bashkëpronarët e pasurisë objekt kontrate, për periudhën e marrë në analizë, në shumën totale prej 430.000 lekësh, si e ardhur e ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

Nga vlerësimi financiar i kryer mbi të dhënat e mësipërme, duke përfshirë dhe shpenzimet e kryera për të përballuar kostot e jetesës nga familja e znj. B. O. prej 3 personash, si një standard i përdorur



tashmë për analizimin e mundësive financiare të personave të tjerë të lidhur<sup>22</sup>, sipas jurisprudencës së Kolegjit, rezultoi se huadhënësja kishte mundësi për të financuar krejtësisht shumën prej 8.000 eurosh me të ardhura të ligjshme, sipas standardit kushtetues, dhënë hua znj. E. Zh. në maj të vitit 2013.

65. Për huanë e marrë në shumën 10.000 euro, nga znj. E. Zh. prej znj. K. Zh., trupi gjykues vëren se kjo marrëdhënie është vërtetuar nga subjekti i rivlerësimit me anë të deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.02.2019, sipas së cilës znj. E. Zh., në maj 2013, ka marrë hua pa interes nga kushërira e saj, znj. K. Zh., shumën 10.000 euro, për blerjen e një apartamenti në Tiranë. Kjo shumë i është kthyer huadhënëses në mënyrë periodike deri në muajin dhjetor 2014. Në ndryshim nga pretendimi i Komisioneres Publike, trupi gjykues krijoi bindjen mbi vërtetësinë e kësaj marrëdhënieje, duke vlerësuar në harmoni rrethanat në vijim. Mes znj. E. Zh. në cilësinë e huamarrëses dhe znj. K. Zh. në cilësinë e huadhënëses ekzistonte një marrëdhënie e posaçme, pasi, siç kanë deklaruar edhe në deklaratën e përbashkët noteriale, janë kushërira. Përpos kësaj situatë të lidhjes gjinore mes tyre, ndihma financiare e dhënë nga znj. K. Zh. ka konsistuar në një hua dhe jo dhurim, shumë të cilën ajo e ka rimarrë përsëri brenda vitit 2014. Gjithashtu, fakti që huadhënësja është treguar aktive gjatë procesit, duke vënë në dispozicion dokumentacionin që provon të ardhurat e familjes së saj, çmohet se konfirmon ekzistencën e kësaj marrëdhënieje. Me relevancë në këtë analizë u konsiderua edhe fakti se znj. E. Zh. nuk ka qenë asnjëherë zyrtar deklarues i interesave privatë pranë ILDKPKI-së, duke mos pasur kështu detyrimin për të dokumentuar në kohën e kryerjes së tyre veprimet juridiko-financiare të marrjes së huasë prej saj.
66. Sa i përket aftësisë financiare të znj. K. Zh. për të dhënë huanë në shumën 10.000 euro, trupi gjykues vlerësoi prapësimet e subjektit të rivlerësimit, i cili u mbrojt me prezantimin e të dhënave të lëvizjeve të llogarisë bankare të z. H. Sh.<sup>23</sup>, bashkëshorti i znj. K. Zh., i cili prej vitesh ka qenë aksioner në masën 50%, në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, me objekt të gjerë veprimtarie në fushën e tregtisë, transportit, punime duralumini, prodhim i materialeve të ndërtimit.
- Nga verifikimi i lëvizjeve bankare, rezultoi se llogaria e z. H. Sh., në datën 23.07.2012, është kredituar në shumën 12.000 euro, me përshkrimin: *Kalim nga R. Sh., likuidim detyrimi*. Gjithashtu, nga llogaria bankare në lekë për periudhën janar - 13 maj 2013, janë tërhequr 1.106.000 lekë.
- Nga verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2013 të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, informacion i marrë nga burime të hapura, në faqen zyrtare në internet të Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezultoi se kjo shoqëri në fund të vitit kontabël 2012, ka disponuar mjete monetare në shumën prej 2.063.126 lekësh dhe në fund të vitit 2013 ka disponuar shumën prej 5.086.887 lekësh. Referuar këtyre

<sup>22</sup> Edhe pse në vijim të qëndrimit në paragrafin 63 të këtij vendimi, standardi i Kolegjit nuk mund të zbatohet për mundësinë financiare të huadhënëses së znj. E. Zh., pra për znj. B. O..

<sup>23</sup> Sjellë në cilësinë e provës gjatë gjykimit në Kolegj, në seancën gjyqësore publike të datës 28.09.2023.

treguesve financiarë, trupi gjykues arrin në përfundimin se kjo shoqëri ka pasur një situatë të shëndetshme financiare.

Në vijim të këtij parashtrimi dhe qëndrimit të mbajtur në paragrafin 63 të këtij vendimi, konstatohet se familja Shkëmbi ka pasur situatë të mirë ekonomiko-financiare dhe ka disponuar vlera të mjaftueshme për të dhënë hua shumën 10.000 euro.

Në përfundim, nga analiza e kryer në Kolegji, rezultoi se znj. K. Sh. dhe bashkëshorti i saj kishin mundësi të krijonin me burime të ligjshme shumën prej 10.000 eurosh, dhënë hua znj. E. Zh..

Nga analiza financiare e kryer në Kolegji mbi konkluzionet e arritura nga arsyetimi si më sipër lidhur me burimet financiare të përdorura nga znj. E. Zh., trupi gjykues arriti në konkluzionin se ajo mbulonte me të ardhura të ligjshme, pagesat për blerjen e pasurisë “apartament banimi me sipërfaqe 91,91 m<sup>2</sup>”, në Tiranë, në të cilën ishte bashkëpronare me subjektin e rivlerësimit Arbër Çela.

67. Në përfundim, për këtë shkak ankimi, trupi gjykues, bazuar në argumentin e pasqyruar në paragrafin 48 të këtij vendimi, vlerëson se Komisionerja Publike ka hequr dorë nga ky shkak ankimi, duke konsideruar znj. E. Zh. si bashkinvestitore me subjektin e rivlerësimit në këtë pasuri.
68. Në përfundim, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues çmoi se pasaktësia në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, për mosdeklarimin e huasë së marrë nga z. F. H. si burim financiar krijimi për pasurinë apartament, e pashoqëruar me mungesë burimesh të ligjshme, si konkluzion i vetëm brenda këtij kriteri, nuk mund të kualifikohet si deklaram i pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit Arbër Çela ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

*C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe ato të dala si gjetje në kontrollin e figurës*

69. Komisionerja Publike, bazuar dhe në Rekomandimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, datë 06.02.2023, ka ankimuar vendimin e Komisionit nr. 595, datë 07.12.2022, lidhur me përfundimet e arritura pas shqyrtimit e vlerësimit të çështjeve gjyqësore, referuar informacionit të organit ligjzbatues, përfshirë edhe ato të analizuara në kontrollin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, për shkak të denoncimeve të publikut.

*A. Lidhur me shkaqet e ankimit që i referohen gjetjeve në raportin e DSIK-së*

70. Nga kontrolli i vendimit, trupi gjykues konstatoi se në vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës, në trajtimin e çështjeve të referuara nga raporti i DSIK-së, Komisioni, pasi ka pasqyruar gjetjet e hetimit administrativ dhe qëndrimin e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, nuk ka arritur në përfundime konkrete për secilën prej tyre, por në konkluzionet përfundimtare mbi

secilin prej kriterëve të rivlerësimit, ka konkluduar se: *“Lidhur me vlerësimin për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, sa i përket çështjeve të trajtuara në kreun B, “Kontrolli i figurës”, trupi gjykues, nga një vlerësim i thellë i situatës, vlerësuar sipas kriterëve të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, ku vlerësuesi duhet të çmojë aftësitë e gjyqtarit pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet, çmon se në gjetjet e rezultateve të hetimit, në raport me shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij, problematikat e hasura janë çështje gjyqësore që duhen zgjidhur nga gjykatat më të larta, duke mos cenuar lirinë dhe të drejtat e gjyqtarit në vendimmarrje. [...]. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se nuk ka vend për aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi në bindjen e tij të brendshme ato janë çështje që kanë të bëjnë me zgjidhjen e themelit të çështjes e që duhen trajtuar në shkallët më të larta të gjykimit”*.

71. Komisionerja Publike ka kundërshtuar vendimin e Komisionit nr. 595, datë 07.12.2022, lidhur me konkluzionin e mësipërm, duke parashtruar në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj, se referuar informacionit të përcjellë nga DSIK-ja rezultojnë disa rrethana, të cilat të analizuara së bashku me rezultatet e tjera të hetimit, përfshirë vlerësimin e aftësive profesionale, në vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, si dhe të para në raport me njëra-tjetrën, duhen çmuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
72. Në lidhje me vendimin penal të gjyqtarit të seancës paraprake, nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që i përket të pandehurit A. L., Komisionerja Publike ka pretenduar se *ky dokument duhet të vlerësohet në kuadër të njohurive ligjore të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, si një nënindikator në vlerësimin e kriterit profesional dhe/ose të konsiderohet në vlerësimin tërësor të procedurave bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të krijuar bindjen e plotë se subjekti nuk ndodhet në kushtet e papërshtatshmërisë për të vazhduar detyrën.*
73. Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi si vijon.

**73.1** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër<sup>24</sup>, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2019, të gjyqtarit të vetëm subjektit të rivlerësimit Arbër Çela, me kërkues Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, të pandehur A. L., viktima Xh. V., me objekt “Dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. {\*\*\*}, viti 2018, me të pandehur A. L. akuzuar për kryerjen e veprave penale “Vrasje me dashje” mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 76 dhe 22 të Kodit Penal dhe “Mbajtje pa leje i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal”, ka vendosur: *Rrëzimin e kërkesës së prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq, kthimin e akteve*

---

<sup>24</sup> Vendim i përcjellë në Komision nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 20.06.2022.

*prokurorit të hetimit paraprak për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga “Vrasje me dashje e mbetur në tentativë” parashikuar nga nenet 76 dhe 22 të Kodit Penal në “Plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal. Gjykata ka vendosur gjithashtu se kundër këtij vendimi nuk lejohet ankimi.*

Nga të dhënat e pasqyruara në përmbajtjen e këtij vendimi, rezultoi se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar më datë 05.05.2018 procedimin penal nr. {\*\*\*}, në ngarkim të të pandehurit A. L., për kryerjen e veprave penale “Vrasje me dashje” mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 76 dhe 22 të Kodit Penal dhe “Mbajtje pa leje i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal. I pandehuri A. L. ka qëlluar me armë zjarri viktimën Xh. V., në grindje e sipër për shkak të rregullimit të disa tubave të ujit nga shoqëria që po ndërtonte rrugën Shkodër-Velipojë e, për pasojë, viktimë, përfaqësues i shoqërisë, ka marrë disa plagë me armë zjarri në pjesët e poshtme të trupit.

**73.2** Në arsyetimin për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga “Vrasje me dashje e mbetur në tentativë”, parashikuar nga nenet 76 dhe 22 të Kodit Penal në “Plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, ka argumentuar se prokuroria në mënyrë të gabuar veprimet e kryera nga i pandehuri i ka kualifikuar si vrasje me dashje e mbetur në tentativë, duke përcaktuar se qëllimi kriminal i tij nuk ka qenë dëmtimi i shëndetit të viktimës, por marrja e jetës nëpërmjet shkaktimit të dëmtimeve fizike të papajtuësme me jetën. Në të kundërt, nga analiza e provave të marra dhe të shqyrtuara, arrihet në konkluzionin logjik se qëllimi kriminal i të pandehurit nuk ka qenë vrasja, por plagosja e viktimës. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka çmuar se prokuroria ka bërë një interpretim të gabuar të objektit juridik të cenuar nga i pandehuri. Sipas subjektit të rivlerësimit, nga ana e prokurorisë, në asnjë moment të kërkesës nuk arsyetohet se përse është konkluduar se qëllimi i të pandehurit ka qenë jo dëmtimi i shëndetit, por marrja e jetës së viktimës; përse vepra penale ka mbetur në tentativë dhe cilat kanë qenë rrethanat apo faktorët që kanë penguar autorin e veprës për të arritur qëllimin e synuar. I pandehuri ka pasur në posedim të tij armë zjarri të mbushur minimalisht me 6 fishekë, tërësisht e përshtatshme për realizimin e qëllimit kriminal të vrasjes së viktimës, nëse i pandehuri nuk do të kishte pengesa, të cilat bënë që vepra penale apo synimi i tij të mbetej në tentativë. Subjekti i rivlerësimit ka vijuar arsyetimin se nga dy akt ekspertimet mjekoligjore të administruara ka rezultuar se viktimë është qëlluar në të dy këmbët e tij, zona në të cilat nuk ka asnjë organ jetësor, dëmtimi i të cilit do t'i sillte vdekjen. Sipas aktit të ekspertimit kimik, viktimë dhe i pandehuri kanë qenë në afërsi me njëri-tjetrin, për pasojë zona e trupit ku është goditur viktimë nuk është gabim në qitje, por zgjedhje e të pandehurit për ta goditur atë në zona të parrezikshme për jetën, me përjashtim të vetëm një herë që i pandehuri ka goditur në drejtim të kokës së viktimës me qytën e pistoletës dhe jo me qitje me armë. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se prokuroria në asnjë moment nuk ka arsyetuar se përse në rastin konkret vepra ndërpritet e nuk përfundohet për rrethana të pavarura nga vullneti i të pandehurit, sipas nenit 222

të Kodit Penal. Subjekti i rivlerësimit ka arritur në konkluzionin se prokuroria nuk i ka dhënë faktit penal një përcaktim të saktë ligjor, duke e cilësuar atë në mënyrë të gabuar.

Në disponimin e vendimit “*Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankimi*”, subjekti i rivlerësimit i është referuar nenit 407 të Kodit të Procedurës Penale, duke arsyetuar se nga ana e ligjvënësit nuk është përcaktuar e drejta e ankimit, në rastin e kthimit të çështjes për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, siç është përcaktuar në rastet e tjera të disponimit të gjykatës.

**73.3** Kundër vendimit nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2019, është ushtruar ankimi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër e kjo e fundit, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.03.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me këtë ndryshim: *Urdhërohet prokurori të kryejë veprimet sipas drejtimeve të përcaktuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, brenda 60 ditëve nga dita e regjistrimit të akteve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

Gjykata e Apelit Shkodër ka arsyetuar se për sa i përket së drejtës së ankimit, në rastet kur dispozita e posaçme nuk shprehet për të drejtë ankimi, nuk mund të arrihet në përfundimin se kundër këtij vendimi nuk lejohet ankimi. Gjykata e Apelit Shkodër ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së faktit për kthimin e akteve prokurorit është i drejtë dhe i bazuar në ligj, por aktet nuk i duhen kthyer prokurorit për formulimin e akuzës së plagosjes së lehtë, por për plotësim hetimesh, për shkak se hetimet janë të paplota dhe duhen plotësuar me veprime të tjera hetimore për t'i dhënë përgjigje edhe pretendimeve të parashtruara nga viktimat, si dhe për të qartësuar rrethanat e faktit në raport me të gjitha provat që janë siguruar nga prokuroria.

**73.4** Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me gjetjet mbi zbatimin e ligjit procedural penal, nga të cilat dukej se ai kishte favorizuar pozitën e të pandehurit gjatë vendimmarrjeve të tij<sup>25</sup>.

Në përgjigje të barrës së provës lidhur me sa më sipër, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar qëndrimin e tij se: “*[...] është arsyetuar përse në rastin konkret nuk lejohet e drejta e ankimit ndaj vendimit gjyqësor. Në rastin konkret kam*

---

<sup>25</sup> Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, si vijon. “*Nga verifikimi në raport me legjislacionin në fuqi rezulton se vlerësimi i gjyqtarit lidhur me ndryshimin e cilësimit juridik është bërë në referim të gabuar ligjor, pasi kjo procedurë është parashikuar, në pikën 3, të nenit 332/d të Kodit të Procedurës Penale (e cila mund të jetë edhe një lapsus nga gjyqtari). Gjyqtari nuk është shprehur në vendimin përfundimtar lidhur me veprën penale “Mbajtje pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, e cila duket se është harruar me dashje. Vendimi i gjyqtarit Arbër Çela për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale duket se është i gabuar, pasi në rrethanat kur nga hetimet e prokurorisë nuk dilte i qartë fakti penal, gjyqtari duhet t'i kthente aktet për plotësim hetimi dhe jo citim të veprës penale, e cila është detyrë e organit të akuzës në varësi të rrethanave të rezultuara nga hetimi. Duket se gjyqtari është shprehur në dispozitiv mbi ndalimin e ushtrimit të së drejtës së ankimit në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Rezulton se gjyqtari Arbër Çela është shprehur edhe për kërkesën e prokurorisë për gjykimin e çështjes edhe për masën e sigurisë për këtë të pandehur. Në përfundim të sa më sipër, duket se gjyqtari Arbër Çela ka marrë vendim në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal. Duket se gjyqtari ka favorizuar pozitën e të pandehurit gjatë vendimmarrjeve të tij”.*

zbatuar ligjin, por edhe praktikën e gjykatave të tjera të cilat kanë qenë konsekuente në interpretimin e faktit se ndaj këtyre lloj vendimesh nuk lejohet e drejta e ankimit (vendimi nr. {\*\*\*}, datë 30.05.2018, i Gjykatës së Apelit Tiranë; vendimi nr. {\*\*\*}, datë 09.04.2019, i Gjykatës së Apelit Durrës). Po ashtu, theksoj se arsyetimi i dhënë nga ana ime përputhet edhe me praktikën e Gjykatës së Lartë [...]. Në rastin konkret vendosja apo jo e të drejtës së ankimit është e karakterit informues kryesisht për palën që nuk ka njohuritë ligjore. Nga ana e prokurorit është vlerësuar vetë nëse duhet të paraqiste ankim apo jo dhe parashikimi i vendosur nga unë në vendim nuk e ka penguar këtë të fundit të ushtrijë të drejtat e tij dhe, si rrjedhojë, nuk ka sjellë asnjë pasojë ligjore. [...] Nga Gjykata e Apelit nuk janë gjetur shkelje procedurale në gjykim, madje e ka gjetur të drejtë vendimin tim për kthimin e çështjes prokurorit dhe, po ashtu, është bashkuar me qëndrimin tim për mungesë të elementëve të veprës penale të “Vrasjes me dashje e mbetur në tentativë”, parashikuar nga nenet 76 dhe 22 të Kodit Penal. Ndërkohë që divergjenca midis vendimmarrjes së dy gjykatave lidhet me vlerën provuese të provave, konkretisht aktit të ekspertimit mjekoligjor. Në çështjen konkrete, unë i jam referuar dy akteve të ekspertimit mjekoligjor të paraqitur nga prokurori në gjykim. Nga mendimi shkencor i paraqitur në këto dy akte ekspertimi të depozituara nga vetë organi i prokurorisë në gjykim, nuk rezultonte në asnjë moment se plagët e marra te viktima kanë qenë të rrezikshme për jetën në momentin e shkaktimit apo të kenë shkaktuar dëmtim permanent te viktima [...]”. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale është bërë në referim të gabuar ligjor, subjekti i rivlerësimit ka pranuar se është lapsus, shkronja “d” është shënuar “dh”.

74. Komisionerja Publike, në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj, ka parashtruar se qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në arsyetimin dhe disponimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2019, duhet të vlerësohet në kuadër të njohurive ligjore, sipas nenit 72 të ligjit nr. 96/2016 dhe/ose të konsiderohet në vlerësimin tërësor të procedurave, bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke argumentuar se:

74.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga “Vrasje me dashje mbetur në tentativë” në atë të “Plagosjes së lehtë me dashje”, është bërë në referencë të gabuar ligjore, pasi kjo procedurë është parashikuar në pikën 3, të nenit 332/d të Kodit të Procedurës Penale.

74.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga “Vrasje me dashje mbetur në tentativë” në atë të “Plagosjes së lehtë me dashje”, nuk gjen mbështetje në situatën faktike dhe juridike të rastit konkret, pasi në rrethanat kur nga hetimet e prokurorisë nuk dilte i qartë fakti penal, subjekti i rivlerësimit duhet t’i kthente aktet për plotësim hetimi, siç ka vendosur edhe Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.03.2019, e cila ka urdhëruar prokurorinë të kryejë hetime brenda 60 ditëve nga regjistrimi i akteve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

74.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në dispozitivin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2019, mbi ndalimin e ushtrimit të së drejtës së ankimit, është bërë në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për pushimin e çështjes.

75. Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit mbajti të njëjtin qëndrim si në shpjegimet e dhëna në Komision mbi rezultat e hetimit administrativ, duke theksuar se shkaku i ankimit të Komisioneres Publike, jo vetëm është tërësisht i pabazuar, por ai ka të bëjë me vlerësimin e provave dhe vendimmarrjen e gjyqtarit, aspekt i cili nuk është në kompetencë të organeve të rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në çështjen objekt kontrolli ka dhënë një vendim të bazuar në ligj e në prova, duke respektuar të gjitha dispozitat materiale dhe procedurale, por edhe praktikën e gjykatave më të larta. Për të provuar këtë fakt, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur gjatë gjykimit në Kolegj disa vendime të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, të cilat u administruan në cilësinë e provës në këtë gjykim.

76. Në analizë të pretendimeve të Komisioneres Publike, në raport me prapësimet e subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i arsytimit të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2019, trupi gjykues vëren se në faqen 8 të këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit, ndonëse ka cituar nenin 332/dh, pika 3 të Kodit të Procedurës Penale, në vijim ka cituar të plotë përmbajtjen e pikës 3, të nenit 332/d të këtij Kodi, e cila është referenca e saktë ligjore, konkretisht: *“3. Kur gjatë seancës paraprake del se cilësimi juridik i faktit është i gabuar, ose kur akuza nuk është formuluar në mënyrë të qartë dhe të saktë, gjykata fton prokurorin që të bëjë korrigjimet ose saktësimet e nevojshme. Në rast se prokurori nuk vepron, gjykata vendos t’i kthejë aktet. Ky vendim i njoftohet drejtuesit të prokurorisë”*. Për pasojë, referimi i gabuar i dispozitës procedurale, qartësisht duket se ka qenë një lapsus në shkrim, i cili në fakt nuk ka pasur asnjë peshë në arsyetimin dhe disponimin e vendimit objekt shqyrtimi, duke e përjashtuar subjektin e rivlerësimit nga kryerja e ndonjë parregullsie, në qëndrimin për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale.

77. Sa i takon pretendimit të Komisioneres Publike, siç është cituar në paragrafin 71.2 më sipër në këtë vendim, nga analizimi i pjesës arsyetuese të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 18.03.2019, të Gjykatës së Apelit Shkodër, trupi gjykues vëren se thelbi i ndryshimit të urdhërimit të prokurorit për të kryer veprime të tjera hetimore në drejtim të sqarimit të rrethanave të ngjarjes dhe cilësimit juridik të veprës penale të konsumuar nga i pandehuri lidhet me vlerësimin e ndryshëm që dy gjykatat i kanë bërë provave, konkretisht akteve të ekspertimit mjekoligjor të viktimës, në drejtim të pasojave në shëndet, që i kanë ardhur atij nga veprimet e të pandehurit. Gjykata e apelit ka vlerësuar se gjykata e faktit ka konkluduar në pamjaftueshmërinë e fakteve dhe arsyetimin e akuzës nga prokuroria, për cilësimin juridik të veprës penale *“Vrasje me dashje mbetur në tentativë”*, por për gjykatën e apelit përfundimi i gjykatës së faktit se nga prokurori duhet formuluar akuzë për plagosjen e lehtë nuk është i bazuar në provat që janë administruar gjatë hetimeve paraprake për ekzistencën e kësaj

vepre penale. Sipas gjykatës së apelit, përfundimi që kanë dhënë aktet e ekspertimeve mjekoligjore për plagosjen e lehtë vihet në diskutim nga ndërhyrjet e mëpasshme kirurgjikale që ka pasur viktimja për të shëruar plagët nga arma e zjarrit. Një nga detyrat që i është lënë prokurorit nga kjo gjykatë është edhe kryerja e një akti tjetër mjekoligjor me një grup minimalisht prej 3 ekspertësh mjekoligjorë për të dhënë konkluzione bindëse në lidhje me natyrën e plagosjes së viktimës etj. Komisionerja Publike ka mbështetur pretendimin e tij në këtë arsyetim të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Trupi gjykues çmoi se elementet e analizuara më sipër janë elemente vlerësimi mbi korrektësinë dhe themelshmërinë e vendimit, mbështetur në mënyrën e vlerësimit të provave dhe në bindjen e brendshme të disponimit të subjektit të rivlerësimit në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Referuar përcaktimeve të nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, si dhe qëndrimit të mbajtur në jurisprudencën e Kolegjit<sup>26</sup>, trupi gjykues vlerëson se kjo çështje e tejkalon objektin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, aftësitë gjyqësore të të cilit çmohen pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e tij.

78. Lidhur me pretendimin e Komisioneres Publike se qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në dispozitivin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2019, mbi ndalimin e ushtrimit të së drejtës së ankimit, është bërë në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për pushimin e çështjes, trupi gjykues vlerësoi se:

*Së pari:* në ndryshim nga sa ka perceptuar Komisionerja Publike në ankim, subjekti i rivlerësimit në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2019, nuk ka disponuar me pushimin e akuzës ose të çështjes penale, që prokurori të gjendej në kushtet e parashikuara nga pika 2 e nenit 332/gj të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se: “2. *Kundër vendimit për pushimin e akuzës ose çështjes prokurori, i pandehuri dhe viktimja ose trashëgimtarët e saj mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit*”, por në cilësinë e gjyqtarit të seancës paraprake ka vendosur kthimin e akteve prokurorit të hetimit paraprak për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale.

*Së dyti:* neni 332/d i Kodit të Procedurës Penale, ku është bazuar subjekti i rivlerësimit në marrjen e vendimit objekt shqyrtimi, nuk i njeh të drejtën prokurorit që të paraqesë ankim ndaj këtij vendimi, në mbështetje të përcaktimit të nenit 407, me titull “Rastet dhe mjetet e ankimit”, të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se: “1. *Ligji cakton rastet në të cilat vendimet dhe urdhrat e gjykatës mund të ankimohen, si dhe mjetin e ankimit. 2. Ankimi i urdhrave të gjykatës, kur nuk parashikohet ndryshe nga ligji, mund të bëhet vetëm me ankimin kundër vendimit. 3. Mjetet e ankimit janë: apeli, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe kërkesa për rishikim. 4. E drejta e ankimit i takon vetëm atij që ligji ia njeh shprehimisht. Kur ligji nuk bën dallim ndërmjet palëve, kjo e drejtë i takon secilës prej tyre. 5. Kur ankimi bëhet në gjykatën jokompetente, ajo ia dërgon aktet gjykatës kompetente*”. Për sa më lart, vendimet e kësaj natyre të gjyqtarit të seancës paraprake nuk mund të konsiderohen si përfundimtare për efekt të gjykimit të çështjes. Në kushtet kur Kodi i Procedurës

<sup>26</sup> Vendimi i Kolegjit (JR) nr. 25, datë 01.10.2020, paragrafi 116 etj.



Penale e ka përcaktuar vendimin gjyqësor të seancës paraprahe, si aktin që fillon gjykimin dhe ky i fundit ka në objektin e tij përcaktimin e saktë të akuzës me vendimin përfundimtar të themelit, prokurori, i pandehuri dhe viktima, i kanë të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e pozicioneve të tyre gjatë shqyrtimit të çështjes në themel. Për më tepër që në rastin konkret, për shkak të vendimit për kthimin e akteve prokurorit, ky i fundit është i detyruar që, pasi të zbatojë urdhërimet e gjyqtarit të seancës paraprahe, t'i drejtohet sërish atij me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, duke paraqitur edhe provat në mbështetje të akuzës.

Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të drejtë disponimin e subjektit të rivlerësimit në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2019, se ndaj këtij vendimi nuk mund të ushtrohet ankimi, pasi prokurori nuk mund të investojë gjykatën e apelit për shqyrtimin e ankimit ndaj një vendimi të gjykatës së shkallës së parë, për të cilin ligji nuk ia ka njohur të drejtën e ankimit. Trupi gjykues vëren, gjithashtu, se një qëndrim i tillë është mbajtur edhe në praktikën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, sipas së cilit ligji cakton rastet në të cilat vendimet dhe urdhrat e gjykatës mund të ankimohen, si dhe mjetet e ankimit.

79. Në konkluzion, lidhur me vendimin penal nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit Arbër Çela në cilësinë gjyqtarit të seancës paraprahe, trupi gjykues vlerësoi se nuk u gjetën elementë për vlerësim në kuadër të njohurive ligjore të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, brenda nënindikatorëve të vlerësimit të kriterit profesional apo të konsiderimit të kësaj çështje në vlerësimin tërësor të procedurave, bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
80. Në lidhje me vendimin penal nr. {\*\*\*}, datë 12.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që u përket të gjykuarve A.L. e D. P., Komisionerja Publike ka pretenduar se *çështja duhet të vlerësohet në kuadër të njohurive ligjore të subjektit, sipas nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, indikatorit i njohurive ligjore, konkretisht nënindikatorit i lidhur me aftësinë e përgjithshme për të interpretuar ligjin, përkatësisht nenin 380 në harmoni me nenin 362, pika 3 të Kodit të Procedurës Penale.*
81. Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi si vijon.

**81.1** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*}, datë 03.04.2016, për veprën penale të *“Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”* e kryer në bashkëpunim, në ngarkim të të pandehurve A. L. e D. P..

Në përfundim të gjyqimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, kryesues i trupit gjykues të së cilës ishte subjekti i rivlerësimit Arbër Çela, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.12.2016<sup>27</sup>, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit D. P. për veprën penale *“Prodhim dhe shitje e narkotikëve”*,

---

<sup>27</sup>Vendim i përcjellë në Komision nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 06.06.2022.

parashikuar nga neni 238/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim dhe deklarimin të pafajshëm të të pandehurit A. L., pasi nuk provohet të ketë kryer veprën penale objekt akuze.

**81.2** Në vendim, subjekti i rivlerësimit deklarimin e pafajshëm të të pandehurit A. L. e ka mbështetur në arsyetimin se nuk ka prova të mjaftueshme që të bindin gjykatën tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri ka kryer veprën penale objekt akuze dhe, si rrjedhojë, të ketë bashkëpunuar me të pandehurin tjetër D. P.. Sipas gjykatës, fakti i vetëm që ka mjaftuar për organin e akuzës që të marrë në përgjegjësi penale të pandehurin është fakti se ai është gjendur në derën e banesës së të pandehurit P.. Gjykata, në lidhje me këtë provë, ka çmuar se ajo është vetëm një indicie e lehtë, e cila duhet të merret me rezervë në lidhje me fuqinë e saj provuese, bazuar në nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale. Nga ana e prokurorisë nuk u paraqit asnjë provë tjetër apo qoftë edhe indicie, për të konfirmuar se i pandehuri L. po qëndronte para derës së banesës së të pandehurit P., pikërisht për t'i marrë këtë të fundit lëndën narkotike. Gjykata ka hedhur poshtë pretendimin e prokurorisë në kërkesën për gjykim se *nga banesa ka dalë D. P. me dy qese në duar dhe tentuar t'ia japë A. L.. Menjëherë në vend kanë ndërhyrë punonjësit e policisë dhe P. nuk ka mundur t'ia japë qeset L. dhe kur ka parë policinë i ka hedhur ato në tokë.* Në rrëzimin e këtij pretendimi, gjykata është mbështetur në dëshminë e punonjësit të policisë Gj. A., i cili ka qenë pjesëmarrës në ndjekjen dhe ndërhyrjen në vendngjarje, dëshmi nga e cila ka rezultuar se në asnjë moment policia nuk i ka gjetur dy të pandehurit duke shkëmbyer qese me njëri-tjetrin, përkundrazi policia ka mbërritur në vendngjarje para se i pandehuri P. të hapte derën e banesës. Gjykata ka vlerësuar si jobindëse dëshminë e kryeinspektorit të krimeve N. D., pasi ai ka deklaruar se kontrolli në vendngjarje ishte kryer për shkak të informacionit të marrë prej tij në rrugë konfidenciale, të cilat nuk mund t'i zbulonte, se një person po qëndronte afër një shtëpie dhe dyshohej se po kryente vjedhje. Z. D. deklaroi në gjykim se nuk e njihte të pandehurin P. dhe nuk dinte të kishte komunikuar me të në telefon, ndërsa nga tabulatet telefonike rezultoi se ai kishte komunikuar me P. disa minuta para ngjarjes. Gjykata ka arsyetuar se prokuroria nuk arriti të provojë në mënyrë bindëse se i pandehuri L. kishte shkuar në banesën e P. për të marrë lëndën narkotike apo se ky i fundit doli nga banesa për t'ia dhënë atë A. L. e jo për të dalë e për t'ia dhënë për ta shitur dikujt tjetër. Edhe vetë i pandehuri P. gjatë gjykimit ka mohuar kategorikisht që i pandehuri L. të kishte dijeni për lëndën narkotike.

82. Vendimi penal nr. {\*\*\*}, datë 12.12.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është ankimuar nga prokurori dhe i pandehuri D. P. në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.04.2017<sup>28</sup>, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke deklaruar fajtor secilin prej të pandehurve për veprën penale “*Prodhim dhe shitje e narkotikëve*” parashikuar nga neni 238/2 i Kodit Penal dhe dënimin e secilit prej tyre me 7 vjet burgim.

---

<sup>28</sup> *Vendim i njësuar me origjinalin, i paraqitur si provë nga subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit.*

83. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kërkuar subjektin të rivlerësimin të japë shpjegime lidhur me gjetjet mbi zbatimin e gabuar të ligjit procedural penal dhe analizën e gabuar të provave duke deformuar rëndësinë e tyre me qëllim lehtësimin e pozitës së të pandehurve. Në përgjigje të barrës së provës, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me sa më sipër, subjekti ka shpjeguar se: *“Nuk qëndron konstatimi i Komisionit për mosadministrimin si provë të komunikimeve të mëparshëm telefonike mes dy të pandehurve në referim të pikës 3, të nenit 362 të Kodit të Procedurës Penale, për shkakun se [...] këto prova janë administruar nga ana ime në gjykim dhe, jo vetëm kaq, por jam ndalur në vlerësimin e hollësishëm të fuqisë së tyre provuese. Konkretisht jam shprehur se [...] komunikimet tregojnë vetëm njohjen e mëparshme të të dy të pandehurve, por jo bashkëpunim midis tyre. Nga ana e të pandehurve në asnjë moment nuk është mohuar njohja me njëri-tjetrin, madje u pretendua dhe një konflikt që kishin midis tyre për shkak borxhi, konflikt që rezulton dhe nga mesazhet e shkëmbyera. [...] Nga ana e Komisionit referohet në nenin 362 të Kodit të Procedurës Penale që lidhet me kundërshtimin e dëshmisë. Në rastin konkret, siç mund të konstatohet lehtësisht nga procesverbali gjyqësor, nga ana e prokurorisë në asnjë moment nuk është kërkuar kundërshtimi i dëshmive të administruara në gjykim me deklaratimet e dhëna gjatë hetimeve paraprake para prokurorit. Në këto kushte, gjykata nuk ka asnjë mundësi procedurale për të përdorur këto deklaratime, madje këto deklaratime nuk janë fare pjesë e fashikullit gjyqësor dhe kjo parashikohet në nenin 332/ë të Kodit të Procedurës Penale. Pra, nga përmbajtja e këtij neni rezulton se kundërshtimi i dëshmisë mund të bëhet vetëm në bazë të kërkesës së njëres prej palëve (prokurori, i pandehuri) dhe nuk mund të bëhet kryesisht nga vetë Gjykata. [...] asnjë nga palët, aq më pak prokurori, nuk ka paraqitur një kërkesë në kuptim të nenit 362 të Kodit të Procedurës Penale. Nuk qëndron konstatimi i bërë për analizim të gabuar të dëshmive të dhëna nga oficerët e policisë gjyqësore, të cilat kanë qenë të qartë duke konfirmuar bashkëfajësinë e dy të pandehurve. [...] Gjatë arsyetimit të vendimit, me qëllim argumentimin se pretendimi i prokurorisë për bashkëpunim midis të pandehurve nuk qëndron, kam përdorur në mënyrë të saktë dëshminë e punonjësit të policisë të pyetur në gjykim si dëshmitar. [...] siç rezulton nga kjo dëshmi, në asnjë moment policia nuk i ka gjetur të dy të pandehurit duke shkëmbyer drogë me njëri-tjetrin. Vetëm dëshmia e shtetasit N. D., i cili ka deklaruar se i pandehuri P. i ka thënë të pandehurit L. se droga është e jotja, nuk mbështetet as nga vetëdeklarimi i dëshmitarit Gj. A. dhe as nga deklarimi i të pandehurit P.. Ndër të tjera, gjykata në vendim ka analizuar edhe besueshmërinë e dëshmitarit N. D. duke e ballafaquar me provat në gjykim, ku gjykatës i lindën dyshime se dëshmitari nuk ishte i sinqertë në dëshminë e tij. Nga ana tjetër, edhe sikur të kishte rezultuar se i pandehuri në vendngjarje ku ishte prezent policia të kishte deklaruar se droga nuk është e tij, por e personit tjetër kjo do të ishte një reagim jo i pazakontë për sa kohë që i pandehuri në atë situatë, reagim spontan do të kishte shfaqësimin e vetes. [...] Në gjykim ka rezultuar se deklarimi i të pandehurit P. mbështetet nga dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët e thirrur në gjykim, konkretisht të punonjësit të policisë Gj. A. dhe A. L.. Gjithashtu, vjen në përputhje dhe me deklaratimin e të pandehurit A. L.. Në të kundërt, prokuroria nga ana e saj nuk arriti në asnjë*

moment të hedhë poshtë me prova deklarimin e të pandehurit P.. Prokuroria aludoi për bashkëpunim midis të pandehurve nisur vetëm nga fakti se u provua njohja e mëparshme të pandehurve me njëri-tjetrin dhe nisur nga fakti se kur i pandehuri P. doli nga dera e shtëpisë ai kishte në dorë një qese me lëndë narkotike. Ndërkohë që në asnjë moment nuk u provua se i pandehuri L. shkoi të takojë të pandehurin P. për t'i marrë lëndën narkotike. Madje edhe sikur të provohej kjo, në asnjë moment nga ana e prokurorisë nuk u provua një marrëveshje midis tyre për të mbajtur bashkërisht lëndën, për sa kohë fare mirë [...] i pandehuri L. mund të shkonte për të marrë/blerë lëndë narkotike si përdorues dhe në sasi të vogla, ashtu siç bën realisht çdo përdorues i këtyre substancave kur kontakton me shpërndarësit/shitësit e lëndës”.

84. Komisionerja Publike, në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj, ka parashtruar se qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në arsyetimin dhe disponimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2019, duhet të vlerësohet në kuadër të njohurive ligjore, sipas nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, indikatorit njohurive ligjore, konkretisht nënindikatorit i lidhur me aftësinë e përgjithshme për të interpretuar ligjin, përkatësisht nenin 380 në harmoni me nenin 362, pika 3 të Kodit të Procedurës Penale.
- Trupi gjykues vëren se Komisionerja Publike, në parashtrimin e këtij shkakut ankimi, është mbështetur në arsyetimin e bërë nga Gjykata e Apelit Shkodër në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.04.2017, sipas së cilit: “Është e vërtetë që gjatë gjykimit i pandehuri P. ka mbajtur qëndrimin se lënda narkotike ishte tij dhe jo e shtetasit A. L., pra, duke përjashtuar bashkëpunimin midis tyre dhe gjykata e shkallës së parë nuk e ka marrë parasysh deklarimin e këtij shtetasi gjatë fazës së hetimeve se lënda narkotike ishte e të pandehurit L. dhe ai thjesht po e mbante në banesën e tij. Gjykata e shkallës së parë ka rrëzuar këtë provë të prokurorisë me argumentimin se bazuar në nenin 380 të K.Pr.Penale, gjykata e ka të ndaluar të marrë apo përdorë prova që nuk janë marrë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Gjykata e Apelit çmon se është e vërtetë se neni 380 i Kodit të Procedurës Penale parashikon këtë kufizim, por nga ana tjetër neni 362, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale, sanksionon se: “Deklarimet e dhëna para prokurorit ose oficerit të policisë gjyqësore mund të vlerësohen si provë, nëse ato lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.” Pra, si rregull vetëm dëshmia e dhënë para gjykatës merret si provë dhe përjashtimi nga rregulli është që deklarimet e dhëna gjatë hetimeve paraprake mund të merren si provë vetëm kur ato lidhen me prova të tjera, në të kundërt gjykata nuk mund të marrë parasysh në dhënien e vendimit, por thjesht për besueshmërinë e dëshmitarit. Në rastin konkret duke qenë se këto thënie të bashkë të pandehurit P. gjatë gjykimit, nuk gjejnë mbështetje në asnjë prej provave të administruara, (as në komunikimet telefonike mes tyre, arrestimin e tyre në flagrancë, kohën dhe vendin e arrestimit, deklarimet e dëshmitarëve të tjerë punonjës policie lidhur me komunikimin mes tyre në momentin e arrestimit) çojnë në bindjen e përfundimit se këto deklarime nuk janë të besueshme dhe se janë bërë thjesht për të përfutur nga parashikimet ligjore lidhur me kualifikimin juridik të veprës penale për të cilën do të merrej në përgjegjësi penale. Fakti se lënda narkotike i përkiste të pandehurit L., përveç thënieve të dy dëshmitarëve të pyetur në seancë gjyqësore Gj. A.

*dhe N. D., konfirmohet edhe nga akte të tjera shkresore të mbajtura prej tyre dhe prej punonjësve të tjerë të policisë si raporti i shërbimit, procesverbal i kapjes në flagrancë etj.”.*

85. Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit mbajti të njëjtin qëndrim si në shpjegimet e dhëna në Komision mbi rezultat e hetimit administrativ, duke prapësuar se vendimi nr. {\*\*\*}, datë 12.12.2016, i dhënë prej trupit gjykues ku ai ka qenë pjesë, është marrë në përputhje të plotë me ligjin, nuk ka asnjë shkelje procedurale e asnjë favorizim të palëve në gjykim. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë në vëmendje se duke qenë se vendimmarrja e Gjykatës së Apelit është bazuar në një vlerësim të ndryshëm të provave, referuar edhe praktikës së konsoliduar të Kolegjit, shkaku objekt ankimi nuk mund të jetë objekt i kontrollit të organeve të rivlerësimit.
86. Në analizë të pretendimit të Komisioneres Publike, në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër në këtë vendim dhe legjislacionin e zbatueshëm, në rastin konkret, Kodi i Procedurës Penale, i ndryshuar, në versionin në fuqi në dhjetor të vitit 2016, trupi gjykues vëren se në mbështetje të parashikimeve e neneve 362, pikat 3 dhe 4<sup>29</sup> dhe 380<sup>30</sup> të këtij Kodi, deklaratimet e dhëna nga dëshmitari në fazën e hetimit paraprak, megjithëse nuk përbëjnë provë në vetvete, mund të vlerësohen si provë, nëse lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre, si dhe në rastin kur rezulton se dëshmitari, qoftë dhe gjatë pyetjes në seancë, i nënshtrohet dhunës, kanosjes, premtimit për t'i dhënë para ose përfitime të tjera, me qëllim që të mos dëshmojë ose të bëjë dëshmi të rreme, si dhe kur rezultojnë rrethana të tjera që kanë dëmtuar sinjeritetin e përgjigjeve të tij. E njëjta vlerë provuese vlen dhe për deklaratimet e të pandehurit gjatë fazës së hetimit paraprak, në mbështetje të nenit 370, pika 1<sup>31</sup> e Kodit të Procedurës Penale.
87. Nga kontrolli i arsytimit<sup>32</sup> të bërë nga subjekti i rivlerësimit në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.12.2016, trupi gjykues vëren se kundërshtitë mes dy gjykatave, lidhen me deklaratimet

---

<sup>29</sup> Kodi i Procedurës Penale, në nenin 362 “Kundërshtimi i dëshmisë”, në pikat 3 dhe 4 përcakton: “[...] 3. Deklarimet e dhëna para prokurorit ose policisë gjyqësore mund të vlerësohen si provë, nëse ato lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.

4. Deklarimet e mëparshme, të përfshira në fashikullin e gjykimit, sipas pikës 2 të këtij neni, çmohen si prova edhe kur rezulton se dëshmitari qoftë edhe gjatë pyetjes në seancë i nënshtrohet dhunës, kanosjes, premtimit për t'i dhënë para ose përfitime të tjera, me qëllim që të mos dëshmojë ose të bëjë dëshmi të rreme, si dhe kur rezultojnë rrethana të tjera që kanë dëmtuar sinjeritetin e përgjigjeve të tij”.

<sup>30</sup> Kodi i Procedurës Penale, në nenin 380 “Provat që mund të përdoren për të marrë vendimin”, parashikon: “1. Për të marrë vendimin gjykata nuk mund të përdorë prova të tjera veç atyre që janë marrë ose janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor”.

<sup>31</sup> Nenit 370 “Leximi i deklaratimeve të bëra nga i pandehuri” i Kodit të Procedurës Penale parashikon: “1. Për të kundërshtuar, tërësisht ose pjesërisht, përmbajtjen e deklaratimeve të të pandehurit, palët mund të përdorin deklaratimet e bëra më parë nga ai dhe që ndodhen në fashikullin e prokurorit, në qoftë se ka folur për faktet dhe rrethanat që kundërshtohen”.

<sup>32</sup> Sipas arsytimit të subjektit, në konkluzionet përfundimtare, prokuroria, në përshkrimin e akuzës dhe të provave që rëndojnë mbi të pandehurin, ka përmendur se i pyetur në cilësinë e personit nën hetim, D. P. ka deklaruar se lënda narkotike e sekuestruar atij para banesës dhe në banesë është pronë e A. L., i cili ia kishte dhënë para një muaji e

kontradiktore të bëra nga i pandehuri D. P. në seancë gjyqësore, krahasuar me deklaratimet e tij të bëra në cilësinë e personit nën hetim, të cilat ndodheshin në fashikullin e prokurorit e sipas arsyetimit të subjektit të vlerësimit nuk ishin lexuar, debatuar e administruar si provë nga gjykata. Trupi gjykues çmon se është e kuptueshme që, bazuar në parashikimet e nenit 380 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata në vendimmarrje nuk mund të përdorë prova të tjera veç atyre që janë marrë ose janë verifikuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në rastin konkret, referuar fakteve të cituara në vendimet e të dy gjykatave, rezultoi se prokurori, gjatë gjykimit, vetëm në fazën e diskutimeve përfundimtare, ka cituar deklaratimet e të pandehurit të bëra në cilësinë e personit nën hetim, me qëllim për të kundërshtuar dëshminë e të pandehurit dhe jo në fazat e mëparshme të shqyrtimit gjyqësor. Trupit gjykues nuk i rezultoi nga provat e administruara që, në përputhje me përcaktimet e nenit 362, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, dëshmia e të pandehurit të jetë kundërshtuar gjatë gjykimit nga palët, prokuroria dhe të pandehurit e tjerë, ndërsa gjykata nuk mund ta bënte këtë kryesisht.

88. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues nuk gjeti elemente për vlerësim në kuadër të njohurive ligjore të subjektit, sipas nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, konkretisht atë të interpretimit të ligjit si një nënindikator në vlerësimin e kriterit profesional apo të konsiderimit të kësaj çështjeje në vlerësimin tërësor të procedurave bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
89. Në lidhje me vendimin civil nr. {\*\*\*}, datë 27.03.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që i përket kërkueses L. Gj., Komisionerja Publike ka pretenduar se *në gjendjen që rezultojnë aktet, çështja duhet të vlerësohet në kuadër të njohurive ligjore të subjektit, sipas nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, indikatori i njohurive ligjore, konkretisht nënindikatorin i lidhur me aftësinë e përgjithshme për të interpretuar ligjin, përkatësisht nenin 388, paragrafi 3, i ndërlidhur me nenin 32, shkronja "c" e Kodit të Procedurës Civile.*
90. Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi si vijon.

---

*gjysmë për ta mbajtur dhe i kishte thënë se ishte lëndë narkotike dhe do të shkonte t'ia merrte kur t'i duhej. Lidhur me sa më sipër, gjykata i ka tërhequr vëmendjen prokurorisë se për sa kohë vetë gjykata, bazuar në nenin 380 të Kodit të Procedurës Penale e ka të ndaluar të përdorë prova të tjera veç atyre që janë marrë ose janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor, është logjikisht e kuptueshme që dhe për palët është njëkohësisht e ndaluar që të përmendin në konkluzione rrethana apo fakte që nuk e kanë kaluar një procedurë të tillë. Sipas gjykatës, deklarimi i pretenduar nga prokuroria, për sa kohë nuk është kërkuar si provë nga kjo e fundit, nuk është administruar në asnjë lloj forme në gjykim (p.sh. nëpërmjet kundërshtimit të deklaratimit të dhënë para gjykatës) dhe, si rrjedhojë, nuk është debatuar, nuk mund të përdoret nga ana e gjykatës për të dhënë një vendim fajësie.*

**90.1** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me gjyqtar të vetëm subjektin e rivlerësimit, me vendimin civil nr. {\*\*\*}, datë 27.03.2012<sup>33</sup>, me kërkuese L. Gj., person i interesuar Këshilli i Qarkut Shkodër dhe objekt “Vërtetimi i faktit juridik i vendndodhjes së pronës së Rr. N. P. dhe përcaktimin e sipërfaqes së saj në hartë”, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës. Korrigjimin e notës së transkriptimit të datës 15 dhjetor 1930 në favor të shtetasit Rr. P., vetëm për sa i përket sipërfaqes së pronës së pretenduar, duke vendosur si sipërfaqe 1735 dynym, siç rezulton nga akti i ekspertimit. Akti i ekspertimit është pjesë përbërëse e këtij vendimi. [...]”*.

**90.2** Në drejtim të verifikimit të situatës faktike, nga përmbajtja e pjesës arsyetuese të vendimit të sipërcituar, trupi gjykues konstatoi se nga përfaqësuesi me prokurë i kërkueses L. Gj. është kërkuar saktësimi i objektit të kërkesës së paraqitur për korrigjimin e transkriptimit, vetëm për sa i përket saktësimin të sipërfaqes së pretenduar dhe jo caktimit të vendndodhjes së saj, duke e mbështetur këtë kërkim<sup>34</sup> në nenin 388, paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Civile. Referuar notës së transkriptimit nr. {\*\*\*}, datë 15.12.1930, në favor të z. Rr. N. P. është regjistruar një tokë pyll në Velipojë, prej 40 dynym, me kufijtë përkatës të treguar, e regjistruar në radhorin e pronësisë nr. {\*\*\*}, datë 15.12.1930. Sipas kërkueses, prona ka kufizime të sakta, por sipërfaqja e shënuar në notën e transkriptimit nuk është e saktë. Për këtë arsye, kërkuësja i është drejtuar gjykatës për korrigjimin e kësaj sipërfaqeje gjyqësish, me qëllim që të plotësojë dokumentacionin për ta paraqitur në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronës. Në përfundim të gjykimit, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkueses si të bazuar në ligj, duke arsyetuar si vijon: *“Vërtetimi juridik i faktit parashikohet si institut nga neni 388 i Kodit të Procedurës Civile. Nga analiza logjike e dispozitës del e qartë se kërkesat të cilat përmbajnë si bazë ligjore nenin 388 mund të ngrihen për dy lloj situatash juridike, të cilat ndonëse i referohen dy llojeve të ndryshme të kërimit kanë të njëjtat kushte pranimi dhe legjitimimi procedural: (1) vërtetimin e faktit juridik kur akti që pasqyron këtë fakt ka humbur, është zhdukur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose (2) për korrigjimin e atyre akteve të cilat nuk mund të korrigjohen në rrugë tjetër ligjore. Në rastin në shqyrtim, kërkesa me të cilën është vënë në lëvizje gjykata, bazohet pikërisht mbi këtë bazë ligjore, konkretisht korrigjimin e notës së transkriptimit, duke pasqyruar në mënyrë të saktë sipërfaqen e pronës, në bazë të kufijve të vendosur nga vetë kjo notë”*.

**90.3** Kundër vendimit nr. {\*\*\*}, datë 27.03.2012, është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër nga kërkuësja L. Gj., përfaqësuesi i së cilës, gjatë gjykimit në apel, ka deklaruar se heq dorë nga gjykimi i padisë, pasi konflikti do të zgjidhej administrativisht. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 26.07.2012, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

---

<sup>33</sup>Vendim i përcjellë në Komision nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 06.06.2022.

<sup>34</sup> Kjo kërkesë është pranuar nga gjykata me vendim të ndërmjetëm.

**90.4** Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me gjetjet mbi dhënien e vendimit në interpretim të gabuar të dispozitave të ligjit.

Në përgjigje të barrës së provës, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar qëndrimin e tij, në mënyrë të përmbledhur, si vijon: *“Referuar natyrës së gjyqimit, gjykimi për vërtetimin juridik të fakteve është një gjykim grazioz pa palë kundërshtare e, për rrjedhojë, vërtetimi gjyqësor i faktit nuk synon të zgjidhë një konflikt apo mosmarrëveshje, të njohë apo jo një të drejtë, por thjeshtë synon të formësojë apo të ribëjë gjyqësish, provën, shkresën, dokumentin apo aktin e munguar që pasqyrojnë faktin juridik, i cili passjell lindjen, ndryshimin apo shuarjen e një të drejte pasurore apo personale jopasurore të kërkuarit. Pra, gjykimi i posaçëm për vërtetimin gjyqësor të faktit nuk mund të shërbejë si një rrugë për të mënjeluar rrugën e zakonshme kontencioze të zgjidhjes së konfliktit. Aq më tepër që, duke mbajtur parasysh se vendimi gjyqësor i dhënë është i natyrës deklarative, ai nuk është i ekzekutueshëm, pra, nuk është i detyrueshëm për të tretët, me të cilët kërkuari i vërtetimit të faktit mendon se ka një çështje a konflikt për të zgjidhur, gjykata thjesht deklaroi se ajo e konsideron një fakt të dhënë juridik si të vërtetuar, duke lehtësuar në këtë mënyrë realizimin eventual të të drejtave të ligjshme të kërkuarit. Në fund të fundit, të drejtat dhe detyrimet që lindin nga ai fakt juridik i vërtetuar nuk çmohen e vendosen nga gjykata në atë gjykim. Ato zgjidhen nëpërmjet rrugëve të tjera, përfshirë atë të ngritjes së padive në gjykatë me palë kundërshtare”*.

91. Komisionerja Publike, në ankim dhe gjatë gjyqimit në Kolegj, ka parashtruar se çështja duhet të vlerësohet në kuadër të njohurive ligjore të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, konkretisht lidhur me aftësinë e përgjithshme për të interpretuar ligjin, përkatësisht nenin 388, paragrafi 3, i ndërlidhur me nenin 32, shkronja “c” e Kodit të Procedurës Civile, pasi nuk rezultojnë kushtet e domosdoshme për vërtetim gjyqësor të faktit, gjykimi *grazioz*, pasi nota e transkriptimit e datës 15 dhjetor 1930 nuk ka humbur, nuk është zhdukur apo lind nevoja për t’u marrë në një rrugë tjetër, sikurse edhe nuk është objekt *korrigjimi* apo *gabim* sipërfaqja nga 60 dynymë në aktin notë transkriptimi në 1753 dynymë në disponimin e vendimit gjyqësor.
92. Gjatë gjyqimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit mbajti të njëjtin qëndrim si në shpjegimet e dhëna në Komision mbi rezultat e hetimit administrativ, duke theksuar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. {\*\*\*}, datë 27.03.2012, i marrë prej tij, ka qenë në përputhje me ligjin procedural civil, faktet dhe rrethanat që kanë rezultuar gjatë gjyqimit, si dhe provat e administruara.
93. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të pretendimeve të Komisioneres Publike, prapësimeve të subjektit të rivlerësimit në lidhje me to, në analizë të situatës faktike të pasqyruar më sipër, në raport me ligjin procedural lidhur me vërtetimin e faktit juridik, nga përmbajtja e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 27.03.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, vëren se kërkitimi i kërkuarës në këtë gjykim është korrigjimi i notës së transkriptimit nr. {\*\*\*}, datë 15.12.1930, për sa i përket saktësisimit të



sipërfaqes së pretenduar, bazuar ky kërkim në nenin 388 të Kodit të Procedurës Civile, me titull “Kur mund të ngrihet kërkesa”<sup>35</sup>.

Në analizë të kërimit të kërkuases L. Gj. dhe shkakut ligjor ku mbështetet kërkitimi i saj, trupi gjykues çmon se ngritja e kërkesës nuk ka për qëllim korrigjimin e gabimeve të një akti që është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, pasi kërkuasja ka pretenduar qartë se kërkon të korrigjojë sipërfaqen e pronës “pyll në Velipojë” të pasqyruar në notën e transkriptimit nr. {\*\*\*}, datë 15.12.1930. Në rastin konkret akti ekziston, dokumenti që vërteton sipërfaqen e pronës prej 40 dynym është në posedim të kërkuases dhe pikërisht për këtë shkak ajo, me qëllim përdorimin e këtij dokumenti pranë institucioneve shtetërore, kërkon korrigjimin gjyqësish të tij.

Neni 389 i Kodit të Procedurës Civile vendos detyrimin që në kërkesën për vërtetimin e fakteve të tregohen: (a) qëllimi për të cilin kërkuasi paraqet kërkesën për vërtetimin e faktit të caktuar; (b) shkaqet për të cilat nuk mund të merret akti ose për të cilat nuk është mundur që akti të bëhet përsëri; (c) provat me të cilat do të provohet si shkak, për të cilin nuk është e mundur të merret akti ose ky akt nuk mund të bëhet përsëri, ashtu edhe fakti që kërkohet të vërtetohet.

Nga verifikimi i arsytimit të vendimit objekt kontrolli, nën dritën e përcaktimeve ligjore të sipërcituara, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë identifikuar prova të paraqitura nga kërkuasja për të provuar se sipërfaqja e pronës është regjistruar *gabim* në aktin notë transkriptimi nr. {\*\*\*}, datë 15.12.1930. Subjekti i rivlerësimit është limituar në pasqyrimin vetëm të pretendimit të kërkuases se sipërfaqja duhet të ishte më e madhe, pasi në kohën kur është hartuar akti regjistrohej më pak sipërfaqe sesa ajo faktike, me qëllim shmangien nga pagesa e taksave të pronësisë. Trupi gjykues vëren se pretendimi i kërkuases, ndonëse trajtohet prej saj si një *gabim* i organit administrativ, në thelb kërkon ndryshimin në rrugë gjyqësore të sipërfaqes së pronës shumë vite pas disponimit fillestar të organit përkatës dhe cenimin në themel të vendimmarrjes së këtij organi për regjistrimin e pronës me të dhënat përkatëse, duke mos u gjendur kështu në kushtet e një *gabimi*.

Sa më sipër, në konsideratë të shkakut ligjor të kërimit të kërkuases L. Gj. në vendimin objekt kontrolli, lidhur edhe me përmbajtjen e nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile sipas së cilit: *Padia mund të ngrihet: (i) për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur; (ii) për vërtetimin e qenies ose mosqenies së një marrëdhënieje juridike ose një të drejte;*

---

<sup>35</sup> Neni 388 i Kodit të Procedurës Civile, me titull “Kur mund të ngrihet kërkesa” parashikon: “Kur nga një fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, personi i interesuar ka të drejtë të kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të gjykatës së shkallës së parë.

Kërkesa për vërtetimin e fakteve paraqitet në gjykatën e shkallës së parë, në territorin e së cilës ka banimin kërkuasi. Kur kërkohet vërtetimi i faktit për një send të paluajtshëm, ajo paraqitet në gjykatën e shkallës së parë në territorin e së cilës ndodhet sendi.

Në mënyrën e treguar më sipër mund të kërkohet edhe korrigjimi i gabimeve të akteve të treguara në paragrafin e parë të këtij neni”.

(iii) për njohjen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për paditësin, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka identifikuar qartë nëse kërkuesja duhet të kishte paraqitur në kuadër të këtij gjykimi nëse ajo duhet të kishte ngritur një padi, sipas nenit 32, shkronja “c” apo të paraqiste një kërkesë, sipas neneve 388 dhe 389 të Kodit të Procedurës Civile.

*B. Lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*

94. Trupi gjykues konstatoi se Komisioni, në përfundim të kontrollit të kriterit të aftësive profesionale, ka konkluduar se: *“Disa prej gjetjeve përfaqësojnë vlerësime e qëndrime në kapërcim të objektit të organeve të rivlerësimit lidhur me kontrollin e këtij kriteri, përpos gjetjeve që u konstatuan të pambështetura në ligj dhe fakte, sipas vlerësimit të trupit gjykues. Disa nga gjetjet e konstatuara janë të tilla që nuk mjaftojnë për të kualifikuar aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit si nën nivelin minimal kualifikues, për pasojë, në analizë të të gjitha rrethanave të çështjes dhe kuadrit ligjor në fuqi, arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit arrin nivelin minimal kualifikues në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale për efekt të këtij procesi, në kuptim të zbatimit të nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016”.*
95. Komisionerja Publike ka kundërshtuar vendimin e Komisionit nr. 595, datë 07.12.2022, lidhur me konkluzionin e mësipërm, duke parashtruar në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj se, bazuar dhe në Rekomandimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, datë 06.02.2023, vlerëson se të dhënat e rezultuara në një nga denoncimet e publikut, duhen mbajtur në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
96. Në lidhje me faktet e denoncuar në Komision nga denoncuesja znj. R. H., bashkëshortja e z. M. Q., Komisionerja Publike ka pretenduar se *të dhënat e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit lidhur me aftësinë e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, mbeten për t’u vlerësuar sipas indikatorëve të përcaktuar nga neni 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.*
97. Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konkretisht trupi gjykues konstatoi si vijon.

97.1 Me vendimin e datës 13.01.2012, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me arsyetimin se fakti nuk parashikohet si vepër penale, bazuar në nenin 290/1, shkronja “ç” të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur *mosfillimin e kallëzimit nr. {\*\*\*}, të vitit 2011*, mbi kallëzimin e z. M. Q., i cili pretendonte se disa shtetas i kishin thyer banesën, në të cilën jetonte prej shumë vitesh. Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.04.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur pushimin e gjykimit të kërkesës penale, me kërkues M. Q., me objekt “Kundërshtim i vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes nr. {\*\*\*}, të vitit 2011”.

Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 03.02.2014, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur prishjen e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 12.04.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe kthimin e akteve për rigjykim me një tjetër trup gjykues.

**97.2** Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.02.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me gjyqtar të vetëm subjektin e rivlerësimit Arbër Çela, ka vendosur pushimin e gjykimit të kërkesës penale, me kërkuar M. Q., me objekt ankimit ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2011. Në vendim, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se *kërkesa me objekt “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal” është e drejtë ekskluzive e palës kërkuese dhe përbën kusht themelor për zhvillimin e gjykimit. Nëse nuk ekziston kjo kërkesë, gjykata nuk mund të investohet. Në kushtet kur, kërkuesi M. Q. nuk u paraqit në gjykim megjithëse kishte pasur dijeni për seancën gjyqësore dhe nuk kishte paraqitur asnjë shkak për të justifikuar mungesën, në vështrim të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale*, subjekti i rivlerësimit ka çmuar se *gjykimi i kërkesës duhet pushuar*.

**97.3** Gjykata e Apelit Shkodër, e vënë në lëvizje nga ankimi i kërkuarit M. Q., ka vendosur prishjen e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 12.02.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe kthimin e akteve për rigjykim me një tjetër trup gjykues. Gjykata e Apelit, ndër të tjera, ka arritur në konkluzionin se nga gjykata e shkallës së parë është dhënë një vendim i pabazuar, i pambështetur në asnjë dispozitë ligjore, duke vendosur përtej çdo parashikimi të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale pushimin e gjykimit. Sipas kësaj gjykate, arsyetimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë nuk i përgjigjet objektit të kërimit, si në pjesën arsyetuese, ashtu edhe në pjesën urdhëruese, duke qenë një aktvendim i pavlefshëm.

**97.4** Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kërkuar subjektin të rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me gjetjet mbi zbatimin e ligjit procedural penal<sup>36</sup>.

---

<sup>36</sup> Komisioni i ka kaluar subjektin të rivlerësimit barrën e provës, si vijon: “Duket se gjyqtari Arbër Çela ka shqyrtuar dhe gjykuar këtë çështje në kundërshtim me përcaktimet e nenit 18 të Kodit të Procedurës Civile, duke vijuar me kryerjen e veprimeve procedurale, në kushtet kur kjo çështje duhet të ishte pezulluar.

Lidhur me vendimin e datës 12.02.2015, të gjyqtarit Arbër Çela, për pushimin e çështjes me palë kërkuese shtetasin M. Q. dhe objekt “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. {\*\*\*}, të viti 2011, të Prokurorisë së Rrethit Shkodër”, konstatohet se gjyqtari duhet të vijonte me shqyrtimin e kërkesës edhe pa praninë e shtetasit M. Q. dhe në përfundim të vendoste sipas alternativave që lejon ligji procedural penal.

Duket se gjyqtari Arbër Çela ka pushuar këtë çështje në kundërshtim me përcaktimet e nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, duke mos iu përgjigjur objektit të kërimit si në pjesën arsyetuese, ashtu edhe në pjesën urdhëruese. Vendimi i pushimit është i pabazuar, i pambështetur në asnjë dispozitë ligjore, pasi ligji procedural penal për ankimet ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nuk parashikon pushimin e gjykimit.

Duket se gjyqtari Arbër Çela në gjykimin e këtyre çështjeve ka vepruar në kundërshtim të ligjit procedural, duke cenuar dhe mohuar të drejtën e palëve për një proces të rregullt ligjor, parim i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNj-së”.

Në përgjigje të barrës së provës lidhur me sa më sipër, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur se është e vërtetë se për ankimet ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nuk parashikohet pushimi i gjykimit, por nga ana e praktikës gjyqësore është interpretuar se këto lloj kërkesash lidhen ngushtësisht me vullnetin e palës iniciuese të gjykimit. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se qëndrimi i tij mbështetet edhe nga qëndrimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në vendimet nr. {\*\*\*}, datë 03.04.2013 dhe nr. {\*\*\*}, datë 16.01.2013.

98. Komisionerja Publike, në ankim, ka parashtruar se mbi të njëjtin prezumim të kufijve të rivlerësimit të përdorur nga Komisioni konstaton se të dhënat e rezultuara nga hetimi administrativ, lidhur me aftësinë e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, mbeten për t'u vlerësuar sipas indikatorëve të përcaktuar nga neni 72/2 i ligjit nr. 96/2016, referuar dhe jurisprudencës së Kolegjit, duke argumentuar se:

(i) Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në vendimin e datës 12.02.2015, për pushimin e çështjes, lidhur me zbatimin e nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, për shqyrtimin e ankimit në rastin kur palët nuk paraqiten pa shkaqe të arsyeshme, nuk gjen mbështetje në situatën juridike të rastit konkret, pasi ligji procedural, për ankimet ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal, nuk parashikon pushimin e gjykimit.

(ii) Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në vendimin e datës 09.12.2014, për pushimin e çështjes, lidhur me zbatimin e nenit 18 të Kodit të Procedurës Penale, në kushtet kur pala kërkuese M. Q. kishte depozituar në sekretarinë e gjykatës kërkesë për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit, nuk parashikon pushimin e gjykimit, por procesi gjyqësor duhet të ishte pezulluar nga subjekti deri në shqyrtimin e kësaj kërkesë.

99. Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit mbajti të njëjtin qëndrim si në shpjegimet e dhëna në Komision mbi rezultatet e hetimit administrativ, duke pretenduar se ka shpallur vendimin përfundimtar në datën 09.12.2014, vetëm pasi ishte rrëzuar kërkesa për përjashtimin e tij. Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të këtij pretendimi, paraqiti vendimin nr. {\*\*\*}, datë 25.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me të cilin është vendosur rrëzimi i kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit Arbër Çela nga gjykimi i çështjes administrativo-penale nr. {\*\*\*}, datë 20.01.2014, akt i cili u administrua nga trupi gjykues në cilësinë e provës në këtë gjykim. Duke mospezulluar gjykimin pas paraqitjes së kërkesës për përjashtim, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ka zbatuar me korrektësi nenet 18 dhe 22 të Kodit të Procedurës Penale, nga leximi i të cilave rezulton se pezullimi nuk është efekt i menjëhershëm apo detyrues me paraqitjen e një kërkesë për përjashtim, por vlerësohet nga vetë gjykata nëse ka vend për pezullimin e procedurave. Një qëndrim i tillë është mbajtur edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 15.05.2020.

100. Në përfundim të procesit gjyqësor në Kolegj, pasi dëgjoi prapësimet e subjektit të rivlerësimit dhe u njoh me provat e paraqitura prej tij, të cilat u administruan në cilësinë e provës, Komisionerja

Publike, në bisedimet përfundimtare, vlerësoi se lidhur me shkakun ankimor, objekt i të cilit janë dy vendime të marra nga subjekti i rivlerësimit të shqyrtuar në funksion të denoncimeve të shtetases R. H., prapësimet dhe prova e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore publike të datës 28.09.2023, konkretisht akti vendim nr. {\*\*\*}, datë 25.11.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt *kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit Arbër Çela*, sqaruan rrethanat në të cilat është marrë vendimi nr. {\*\*\*}, datë 09.12.2014 dhe sqaron/shëron mangësitë e evidentuara në këtë shkak ankimi, të cilat janë pasqyruar, më sipër në këtë vendim.

Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se këto pretendime nuk duhet të jenë pjesë e vlerësimit në kuadër të këtij procesi, për sa kohë që kërkimi i Komisioneres Publike për ndryshimin e vendimit nuk mbështetet në to, por në shkaqet e tjera të ankimit.

101. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e Komisioneres Publike të paraqitur në ankim dhe të konfirmuar si të tillë edhe në parashtrime e në konkluzionet përfundimtare se qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në vendimin datë 12.02.2015, për pushimin e çështjes, lidhur me zbatimin e nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, për shqyrtimin e ankimit në rastin kur palët nuk paraqiten pa shkaqe të arsyeshme, nuk gjen mbështetje në situatën juridike të rastit konkret, pasi ligji procedural për ankimet ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nuk parashikon pushimin e gjykimit. Trupi gjykues vlerësoi arsyetimin dhe disponimin në vendimmarrjen objekt kontrolli dhe vëren se neni 291 me titull “Vendimi për mosfillimin e procedimit” i Kodit të Procedurës Penale, ligji i kohës, në momentin e shqyrtimit të ankimit nga subjekti i rivlerësimit, parashikonte: *“1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit. 2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë, brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit”*. Nga përmbajtja e kësaj dispozite vërehet se lidhur me gjykimin e ankimit kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal, ligji procedural penal nuk parashikonte hollësi për procedurën që duhet të ndiqet, si duhet të zhvillohet ky gjykim, cilët janë subjektet që duhet të marrin pjesë në shqyrtimin e ankimit kundër vendimit të prokurorit, që ka vendosur mosfillimin e procedimit dhe si duhet të disponohet nëse ankuesi nuk paraqitet në gjykim. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se me këtë vendimmarrje subjekti i rivlerësimit ka zbatuar drejt nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale. Për rrjedhojë, nuk gjenden elemente të cilët duhet të vlerësohen në kuadër të njohurive ligjore të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.

102. Në konkluzion, lidhur me gjetjet në raportin e DSIK-së dhe denoncimin e znj. R. H. në kuadër të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, trupit gjykues i rezultoi që subjekti i rivlerësimit vetëm në vendimin civil nr. {\*\*\*}, datë 27.07.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka pasur mangësi në kuadër të njohurive ligjore, sipas nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, nënindikatorit i lidhur me aftësinë e përgjithshme për të interpretuar ligjin, konkretisht nenin 388 paragrafi 3, i ndërlidhur me nenin 32, shkronja “c” të Kodit të Procedurës Civile. Duke mbajtur në konsideratë edhe që kjo mangësi është e lidhur me një vendim, prej të cilit nuk ka ardhur pasojë, pasi Gjykata e Apelit Shkodër e ka prishur atë për shkak të heqjes dorë nga kërkesa të znj. L. Gj.,

trupi gjykues çmoi se ai nuk mund të sjellë efekt për subjektin e rivlerësimit në vlerësimin e kriterit profesional apo në vlerësimin tërësor të procedurave bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

103. Në mbështetje të sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit, sipas së cilit subjekti i rivlerësimit Arbër Çela ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, është i mbështetur në një vlerësim të drejtë të fakteve, provave dhe legjislacionit të zbatueshëm.
- Në përfundim, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar në ligj vendimin nr. 595, datë 07.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Arbër Çela, për pasojë ai duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 595, datë 07.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Arbër Çela.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 03.11.2023.

#### **ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi – kundër*

#### **ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

#### **ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

## MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtarja Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, kam votuar kundër vendimit (JR) nr. 47, datë 03.11.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 595, datë 07.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Arbër Çela, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në vlerësimin tim, subjekti i rivlerësimit Arbër Çela nuk arrin nivel të besueshëm për t'u konfirmuar në detyrë, me arsyetimin si vijon.

### A. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

2. Sa i përket apartamentit me sipërfaqe 91,91 m<sup>2</sup>, në rr. “{\*\*\*}”, Tiranë, në vlerën 73.528 euro, për mua si gjyqtare në pakicë, zgjidhja e drejtë e çështjes, bazuar në prova dhe në ligj, kërkon fillimisht ndjekjen e procedurës së drejtë ligjore për të përcaktuar saktë marrëdhënien juridike të subjektit të rivlerësimit me pasurinë apartament banimi objekt gjykimi, e më pas analizimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie me të ardhura nga burime të ligjshme.
3. Në vlerësimin tim, konkluzioni i shumicës së trupit gjykues: *[...] se pretendimi i Komisioneres Publike është i pabazuar në fakte dhe në ligj, pasi rrethanat e mësipërme janë të mjaftueshme për të krijuar bindjen e plotë se kontributi real i subjektit të rivlerësimit në krijimin e pasurisë “apartament” ka qenë në masën 50% të çmimit të tij, pra në shumën 36.764 euro, nuk është rrjedhojë e një arsyetimi logjik e bindës, bazuar në fakte dhe në prova, por përpjekje për të favorizuar në mënyrë të padrejtë situatën faktike financiare të subjektit të rivlerësimit.*
4. Në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, çmoj se provat e administruara në dosjen gjyqësore, dokumentacioni bankar i vënë në dispozicion të Komisionit nga Tirana Bank ShA, konkretisht: (a) mandati i depozitimit *cash* të shumës 57.250 euro nga subjekti i rivlerësimit më datë 14.05.2013, në llogari të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me përshkrimin: *Blerje apartamenti, kontratë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.5.2013, me burim kursime dhe huamarrje;* si dhe (b) mandati i depozitimit *cash* të shumës 16.278 euro nga znj. E. Zh. më datë 15.05.2013, në llogari të shoqërisë ndërtuese me të njëjtin përshkrim, provojnë vlerën e investimit të secilit prej tyre në këtë apartament. Nga këto veprime financiare, duket qartë se shuma që realisht ka paguar subjekti i rivlerësimit për blerjen e apartamentit, është 57.250 euro, apo rreth 78% e vlerës së tij, dhe me të drejtë Komisionerja Publike e ka ngarkuar subjektin me përgjegjësi ligjore për të justifikuar këtë shumë.
5. Transaksionet juridike dhe financiare të kryera për këtë pasuri, i çmoj si përpjekje të subjektit të rivlerësimit për të fshehur vlerën reale të paguar prej tij. Ky vlerësim mbështetet në një sërë rrethanash të provuara, të tilla si: (i) porositja e apartamentit nga subjekti i rivlerësimit dhe znj. E.

Zh. nëpërmjet kontratës së porosisë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., më datë 14.05.2013; (ii) pagesa e provuar me mandatin bankar prej 57.250 eurosh nga subjekti i rivlerësimit, dhe 16.278 eurosh nga znj. E. Zh.. Vlerësimin tim e përforcon edhe përmbajtja e shkresave që Tirana Bank ShA i ka përcjellë Komisionit lidhur me këtë çështje, e cila nuk e përjashton subjektin nga detyrimi që ai ka pasur për të paguar pjesën e tij sipas kontributit real financiar, apo për të cituar me ekzaktësi në përshkrim të transaksionit financiar masën e kontributit të tij edhe në kuadër të detyrimit që i ngarkon ligji si subjekt deklarues në kohën e kryerjes së transaksionit. Sa i takon informacionit që Tirana Bank ShA i ka vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit nëpërmjet aktit të administruar në cilësinë e provës në seancën gjyqësore të datës 28.09.2023 në Kolegj, se: *Lidhur me pagesat me para në dorë në favor të palëve të treta, [...] banka nuk e ka të përcaktuar në procedurë nënshkrimin e mandatpagesës nga të gjithë pjesëmarrësit e palës së përshkruar në kontratë dhe faktit që depozitimi i fondeve mund të kryhet edhe nga njëri prej personave që janë pala porositëse [...], nuk mund ta pengonte atë që më datë 14.05.2013, të paguante pjesën takuese të pretenduar, në masën 50% të vlerës së apartamentit prej 36.764 eurosh, dhe znj. Zh. që, sipas tij, ndodhej me të në sportelin e bankës, të paguante më datë 14.05.2013, shumën 20.486 euro (57.250 euro - 36.764 euro) dhe diferencën prej 16.278 eurosh, më datë 15.05.2013, ashtu siç ka ndodhur; (iii) fakti që znj. Zh. ka banuar vetëm për një vit në këtë banesë, dhe më pas pjesën e saj e ka përdorur pa qira subjekti i rivlerësimit, sikurse ai deklaroi në përgjigje të pyetësorit standard se: *Apartamenti në fjalë ka qenë në bashkëpronësi time dhe të shtetasës E. Zh. [...]. Në fillim në këtë apartament kemi banuar bashkë për rreth 1 (një) vit, dhe më pas, rreth muajit mars 2016, shtetasja E. Zh. është larguar duke më lënë pjesën e saj ideale në përdorim, pa qira. Kjo situatë ka vazhduar deri në vitin 2018, kur prindërit e mi kanë vendosur të blejnë pjesën ideale të bashkëpronares; dhe më pas (iv) shitja nga znj. E. Zh. te z. I. Ç., babai i subjektit të rivlerësimit, me anë të kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.10.2018, e pjesës së saj në apartamentin objekt gjykimi, më krijojnë bindjen që subjekti i rivlerësimit nuk mund të ketë paguar kurrsesi vetëm 50% të vlerës së apartamentit të porositur në vitin 2013.**

6. Megjithatë, edhe nëse do të pajtohesh për një moment me konkluzionin e shumicës së trupit gjykues, se shuma e paguar nga subjekti i rivlerësimit është 36.764 euro apo 50% e vlerës së apartamentit, nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore, konstatohet se kredia e pretenduar si burim krijimi për këtë apartament, është disbursuar më datë 27.09.2013, pra, pas blerjes së apartamentit objekt gjykimi, më datë 14.05.2013.

Subjekti, përgjatë hetimit administrativ, ka pretenduar se kredia në shumën 30.000 euro është përdorur për shlyerjen e huasë në të njëjtën shumë, e marrë sipas kontratës së huasë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.06.2013, nga shtetasi F. H., për blerjen e apartamentit. Siç provojnë aktet shkresore, edhe huaja e pretenduar nga subjekti gjatë hetimit administrativ si burim krijimi për apartamentin, është marrë rreth një muaj pas blerjes së këtij apartamenti, gjë e cila e bën të pabesueshëm përdorimin e kësaj huaje si burim për krijimin e kësaj pasurie.



7. Lidhur me ligjshmërinë huasë 30.000 euro, pretenduar nga subjekti, dhënë nga z. F. H., arrij në një konkluzion të ndryshëm nga shumica e trupit gjykues, duke mos u dakordësuar me përfshirjen e saj në mesin e të ardhurave të ligjshme të subjektit të rivlerësimit si burim për krijimin e pasurisë apartament, për këto arsye:

7.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për pasurinë apartament, ndër të tjera: *Kontratë kredie bankare nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., në shumën 30.000 euro*, por nuk ka deklaruar huanë e marrë nga z. F. H., në shumën 30.000 euro.

7.2. Në kuadër të detyrimit për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të shumës 30.000 euro, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, si gjyqtare në pakicë, çmoj se, nga aktet e administruara në Komision, nga korrespondenca e tij me organet tatimore, ashtu edhe nga aktet e depozituara përgjatë seancës publike në Kolegj, nuk u provua që huadhënësi F. H. si individ, të ardhurën nga kontrata e premtimit për shitje të dy trojeve, më datë 25.01.2013, ta ketë përdorur si burim për huanë, ndërkohë që kontrata nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit standard, por është vënë në dispozicion prej tij më vonë, gjatë hetimit administrativ. Nëse konsiderojmë se huaja është dhënë nga personi fizik “F. H.”, pavarësisht faktit që kontrata e huasë është nënshkruar mes palëve si individë, nga përgjigjet e Drejtorisë Rajonale Tatimore nr. {\*\*\*} prot., datë 24.10.2022, rezulton që transaksionet e përmendura në kontratën e premtim shitjes nuk janë pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2013, depozituar në sistemin informatik tatimor. Nga analiza e pasqyrave financiare të personit fizik “F. H.” për periudhën 2008-2013, nuk rezulton që fitimi neto të jetë shpërndarë apo të ketë qenë *cash* në arkë, por rezulton i materializuar në rritje të inventarit të aktivitetit ekonomik.

Mbi pretendimin e subjektit se si burim për huanë 30.000 euro, kanë shërbyer tërheqjet nga llogaritë personale bankare të z. F. H., në analizë të shumave të tërhequra nga llogaria personale e tij, ka rezultuar se për periudhën 2012 – 2013, janë kryer disa tërheqje në *cash*, por shumat e tërhequra janë në vlerat 200.000 - 700.000 lekë, tërheqje të pjesshme, të shtrira në kohë, që nuk duket se mund të kenë shërbyer si burim për krijimin e shumës 30.000 euro, deklaruar dhënë hua subjektit të rivlerësimit. Në vlerësimin tim, kjo hua e pretenduar nga subjekti nuk provohet se ka shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, pasi asnjëherë nuk është deklaruar si burim, as në deklaratën periodike vjetore 2013, as në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe nuk ekziston asnjë gjurmë bankare për kalimin e kësaj shume te subjekti i rivlerësimit, dhe më kryesorja huadhënësi për periudhën në fjalë, nuk kishte mundësi financiare të ligjshme për dhënien e kësaj huaje. Si përfundim, çmoj se subjekti i rivlerësimit nuk provoi mundësitë financiare të huadhënësit F. H. për të dhënë hua shumën 30.000 euro.

Mbi të gjitha, siç e kam trajtuar edhe më lart, kjo hua e evidentuar vetëm përgjatë hetimit administrativ, e pambështetur me asnjë provë tjetër të administruar, e vetme, nuk mund të përmbysë situatën faktike lidhur me pasurinë e subjektit të rivlerësimit, apartament banimi. E

analizuar në çdo këndvështrim, mua si gjyqtare në pakicë, nuk më krijohet bindja që kjo hua është përdorur ndonjëherë për krijim pasurie të subjektit të rivlerësimit Arbër Çela.

8. Lidhur me sa deklaroi subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, se pjesa 50% e apartamentit i përket znj. Zh., në kuadër të hetimit të plotë të çështjes, pavarësisht se nuk e konsideroj znj. Zh. bashkëpronare në këtë pasuri, vlerësoj se pagesat e kryera prej saj, duken si një instrument i përdorur nga subjekti i rivlerësimit për të fshehur vlerën reale të paguar prej tij, për më tepër që znj. E. Zh. nuk provoi mundësinë financiare të saj për të likuiduar 36.764 euro (50% të çmimit prej 73.528 eurosh), më konkretisht:
9. Sipas shumicës së trupit gjykues në vendim: 57. [...] për periudhën 2009 - maj 2013, znj. Zh. ka realizuar të ardhura neto në shumën totale prej 28.770 eurosh. Referuar analizës financiare të kryer në Kolegj, për periudhën në fjalë, rezultoi se znj. Zh. kishte mundësi që nga të ardhurat e ligjshme nga pagat, të paguante shumën prej 18.764 eurosh, si pjesë e pagesës për blerjen e 50% të pasurisë "apartament", pasi pjesa tjetër është përbëlluar nga huatë e marra prej saj për këtë qëllim. Ndryshe nga sa konkludon shumica, në vlerësimin tim, huatë e pretenduara nga E. Zh., në vlerën 18.000 euro në total, 8.000 euro nga shtetasja B. O. dhe 10.000 euro nga K. Zh., të cilat subjekti i rivlerësimit është munduar t'i provojë vetëm me deklaratat noteriale të kryera për efekt të procesit të rivlerësimit në vitin 2017 dhe 2019 përkatësisht, pavarësisht mundësisë financiare të huadhënëseve, nuk janë bindëse, nuk mbështeten në prova të tjera të administruara, por mbeten vetëm në nivel deklarativ dhe përfaqësojnë një përpjekje të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie. Mbështetur në praktikën e konsoliduar tanimë të Kolegjit në lidhje me vlerën provuese dhe rezervën në lidhje me deklaratat noteriale të lëshuara për qëllime të procesit të rivlerësimit, huatë në shumën 18.000 euro, vlerësoj se nuk konsiderohen burime të ligjshme për krijimin e apartamentit 91,91 m<sup>2</sup>. Në përfundim, pa përfshirë huatë në të ardhura të ligjshme me arsyetimin e mësipërm, si dhe duke konsideruar të ardhura neto nga pagat e znj. Zh., vetëm ato të ardhura të cilat përmbushin kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, analiza financiare e kryer rezulton me pamjaftueshmëri në vlerën (-) 4.601.765 lekë, duke e vendosur atë në kushtet e pamjaftueshmërisë për pagesën e shumës 36.764 euro (apo 5.154.680 lekë) të pretenduar.
10. Mbështetur në analizën më sipër, çmoj se subjekti i rivlerësimit Arbër Çela është pronar i këtij apartamenti, pasi nga dokumentacioni i administruar, provohet se ai ka paguar rreth 78% të vlerës së apartamentit më datë 14.05.2013, ose shumën 57.220 euro, dhe përfshirja e znj. E. Zh. vlerësoj se ka pasur për qëllim justifikimin e pasurisë së krijuar nga subjekti i rivlerësimit.
11. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhurat e tij të ligjshme vlerën 36.764 euro, ose 50% të vlerës së apartamentit, kurrsesi nuk do të mund të justifikonte vlerën 57.220 euro të paguar sipas dokumentacionit provues, dhe mungesa e burimeve të ligjshme do të thellohej duke arritur në vlerën (-) 7.304.299 lekë, si përcaktuar në rekomandimin e ONM-së dhe ankimin e

Komisioneres Publike, duke e vendosur kështu subjektin e rivlerësimit në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, e mjaftueshme dhe për të bërë të zbatueshëm nenin 61, pika 3 e këtij ligji, deklaram i pamjaftueshëm i pasurisë.

12. Për sa arsyetuar më sipër, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit Arbër Çela nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Mënyra e deklarimeve dhe sjellja e subjektit përgjatë procesit të rivlerësimit, më krijuan bindjen se ky subjekt tenton të fshehë faktet e vërteta lidhur me këtë pasuri.

*B. Lidhur me gjetjen në raportin e DSIK-së në kuadër të kontrollit të figurës:*

13. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), si një nga institucionet përgjegjëse për ushtrimin e kontrollit të figurës, me anë të raportit nr. {\*\*\*} prot., datë 20.05.2022, ka konstatuar: ***“Papërshatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Arbër Çela.***
14. Në kuadër të raportit të DSIK-së, lidhur me konstatimin se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, dyshohet se është përfshirë në veprime që kanë sjellë si pasojë shpërdorim detyre dhe veprime korruptive, Komisioni ka vlerësuar të verifikojë më tej këto të dhëna në formë *indiciesh*. Në këtë drejtim, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Komisionit, ndër të tjera, i është përcjellë informacion dhe kopje e vendimeve gjyqësore, lidhur me: (i) çështjen penale nr. {\*\*\*}, ndaj shtetasit A. L.; (ii) çështjen penale me të pandehur A. L., D. P.; (iii) çështjen civile me kërkuese L. Gj..
15. ***Në lidhje me vendimin penal të gjyqtarit të seancës paraprake, nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që i përket të pandehurit A. L., nga aktet në dosjen gjyqësore, unë gjyqtarja në pakicë konstatoj:***

15.1. Më datë 05.05.2018, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër janë përcjellë materialet për veprat penale “Vrasje me dashje” mbetur në tentativë dhe “Mbajtje pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga nenet 76, 22 dhe 278/1 të Kodit Penal ndaj shtetasit A. L. dhe është regjistruar procedimi penal nr. {\*\*\*}, viti 2018.

15.2. Referuar materialit kallëzues, rezulton se më datë 05.05.2018, rreth orës 12:00, në fshatin Bërdicë, janë përfshirë në një debat shtetasit Xh. V. dhe A. L., si pasojë e dëmtimeve të tubacionit të ujit gjatë ndërtimit të rrugës Shkodër – Velipojë në lotin e parë. Në grindje e sipër, shtetasi A. L. ka qëlluar disa herë me armë në drejtim të shtetasit Xh. V. (përfaqësues i shoqërisë së ndërtimit), i cili ka marrë disa plagë në pjesët e poshtme të trupit, në të dyja këmbët, si dhe është goditur në drejtim të kokës me qytën e pistoletës, dhe pasi është dërguar në Spitalin Rajonal Shkodër është

futur menjëherë në sallën e operimit. Nga këqyrja e vendit të ngjarjes, janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale, gjashtë gëzhoja armë zjarri model 54, kl. 7.62 mm.

15.3. Nga analizimi i dosjes penale, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me gjyqtar H. S., ka disponuar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 08.05.2018, për caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” për të pandehurin A. L., në mungesë, si dhe me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 25.09.2018, ka vendosur “Deklarim ikje” për këtë shtetas.

15.4. Në përfundim të veprimeve hetimore, prokurori i çështjes ka vendosur: “Dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. {\*\*\*}, viti 2018, me të pandehur A. L., akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje” e mbetur në tentativë dhe “Mbajtje pa leje e armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, parashikuar nga nenet 76-22 dhe 278/1 të Kodit Penal”.

15.5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në seancën paraprake, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2019, të gjyqtarit të vetëm, subjektit të rivlerësimit Arbër Çela, ka vendosur: ***Rrëzimin e kërkesës së prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq; kthimin e akteve prokurorit të hetimit paraprak për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga “Vrasje me dashje e mbetur në tentativë”, parashikuar nga nenet 76 dhe 22 të Kodit Penal, në “Plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal; kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.***

15.5.1. Në përmbajtje e këtij vendimi, citohet se: *Gjykata, në seancën gjyqësore të datës 21.02.2019, të zhvilluar me dyer të mbyllura, si dëgjoi diskutimet përfundimtare të palëve, të cilët kërkuan. [...] mbrojtësi i të pandehurit A. L. i cili kërkoj: mendojmë se cilësimi juridik i veprës penale është i gabuar, nuk kemi kundërshtim për dërgimin në gjyq të çështjes, por për cilësimin juridik të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri. Ne mendojmë se duhet të akuzohet për veprën penale 89 dhe 278/1 të Kodit Penal, pra për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje”, dhe “Mbajtje pa leje dhe prodhim të armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit” [...], mbrojtësi i viktimës Xh. V. i cili kërkoj, kthimin e dosjes prokurorisë për hetime më të plota, lidhur me aktin e ekspertimit mjeko-ligjor, zgjerimin e personave të vendosur në përgjim, si dhe mbi hetimin nëse i pandehuri e ka kryer veprën penale vetë apo në bashkëpunim.*

15.5.2. Po sipas përmbajtjes së këtij vendimi, nga ana e prokurorisë është marrë vendimi për kryerje të riexpertimit mjeko-ligjor dhe është administruar po ashtu akti i riexpertimit mjeko-ligjor nr. 2407, datë 10.10.2018, në të cilin është dhënë konkluzioni se: *1. Bazuar në dokumentacionin mjekësor të shqyrtuar, rezulton se te shtetasi Xh. V., si pasojë e dëmtimeve të marra në ngjarjen e ndodhur më datë 05.05.2018, është konstatuar prania e një plage tejskuese armë zjarri në gjurin e majtë, e shoqëruar me thyerjen e pateles (kockë e kupës së gjurit), dy plagë të tjera tejskuese në indet e buta të kofshës së djathtë dhe pulpës së këmbës së majtë, shoqëruar me thyerjen e fibulës (kockë e hollë e kërcirit) së majtë si dhe një plagë shqyese shtypëse në kokë me karakteristikat e përshkruara në akt. 2. Dëmtimet në anësitë e poshtme janë shkaktuar nga qitje me armë zjarri, ndërsa plaga shqyrëse-shtypëse në kokë, është shkaktuar me mjete të forta*

*mprehëse. 3. Dëmtimet e konstatuara te shtetasi Xh. V. hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve që japin humbje të përkohshme të aftësisë për punë në masën mbi 9 (nëntë) ditë.*

**15.5.3.** Pas analizimit të elementeve përbërëse të figurës së veprës penale në vendim, gjykata (subjekti i rivlerësimit) ka arritur në përfundimin se organi i akuzës ka kryer një cilësim jo të saktë të fakteve dhe si rrjedhojë, edhe cilësimi juridik i veprës penale është i pasaktë. Pas shqyrtimit të akteve, gjykata konkludon se i pandehuri ka konsumuar tërësisht veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal. Në këtë dispozitë parashikohet se: “Plagosja e kryer me dashje, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”. [...]

*Për rrjedhojë, gjykata, bazuar në nenin 332/dh, pika 3 e K. Pr. Penale, shtuar me ligjin nr. 35/2017, i cili parashikon se: “Kur gjatë seancës paraprake del se cilësimi juridik i faktit është i gabuar, ose kur akuza nuk është formuluar në mënyrë të qartë dhe të saktë, gjykata fton prokurorin që të bëjë korrigjimet ose saktësimet e nevojshme. Në rast se prokurori nuk vepron, gjykata vendos t’i kthejë aktet. Ky vendim i njoftohet drejtuesit të prokurorisë. Në vendimin penal nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2019, objekt shqyrtimi, gjithashtu citohet se duke marrë parasysh se prokurori nuk veproi dhe i qëndroi strikt akuzës së ngritur prej tij, gjykata, bazuar në nenin 332/dh, pika 3 e K.Pr.Penale, çmon se duhet të vendosë t’i kthejë aktet prokurorisë dhe të njoftojë drejtuesin e saj.*

**15.5.4.** Për disponimin se “Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankimi”, subjekti i rivlerësimit i është referuar nenit 407 të Kodit të Procedurës Penale, duke arsyetuar se nga ana e ligjvënësit nuk është përcaktuar e drejta e ankimit, në rastin e kthimit të çështjes për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, siç është përcaktuar në rastet e tjera të disponimit të gjykatës.

**15.6.** Pavarësisht urdhërimit në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, për ndalimin e së drejtës për ankim, pranë Gjykatës së Apelit Shkodër është ushtruar ankimi nga prokuroria pranë kësaj gjykate, kundër vendimit nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.03.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me këtë ndryshim: *Urdhërohet prokurori të kryejë veprimet sipas drejtimeve të përcaktuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, brenda 60 ditëve nga dita e regjistrimit të akteve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

**15.7.** Gjykata e Apelit Shkodër ka arsyetuar se për sa i përket së drejtës së ankimit, në rastet kur dispozita e posaçme nuk shprehet për të drejtë ankimi, nuk mund të arrihet në përfundimin se kundër këtij vendimi nuk lejohet ankimi. Gjykata e Apelit Shkodër ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së faktit për kthimin e akteve prokurorit është i drejtë dhe i bazuar në ligj, por aktet nuk i duhen kthyer prokurorit për formulimin e akuzës së plagosjes së lehtë, por për plotësim hetimesh, për shkak se hetimet janë të paplota dhe duhen plotësuar me veprime të tjera hetimore për t’u dhënë përgjigje edhe pretendimeve të parashtruara nga viktimat, si dhe për të qartësuar rrethanat e

faktit në raport me të gjitha provat që janë siguruar nga prokuroria. Gjithashtu, Gjykata e Apelit e vlerëson mungesë mospasqyrimin në vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor, të akuzës për të pandehurin A. L., për kryerjen e veprës penale të “Mbajtjes pa leje të armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, pasi gjykata në pjesën urdhëruese të vendimit është shprehur vetëm për ndryshimin e akuzës së “vrasjes me dashje” të mbetur në tentativë. Për mua si gjyqtare në pakicë, kjo problematikë e konstatuar nga gjykata e apelit, evidenton një mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit, për të mos thënë të qëllimshme, duke anashkaluar pa trajtuar një veprë penale, për të cilën dispozita ligjore parashikon vetëm dënim me burgim.

**15.8.** Pasi janë kryer veprimet hetimore të përcaktuara në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.03.2019, të Gjykatës së Apelit Shkodër, prokurori ka vendosur dërgimin në gjyq të procedimit penal me nr. {\*\*\*}, viti 2018, me të pandehur A. L., akuzuar për kryerjen e veprës penale “Plagosje e rëndë me dashje” dhe “Mbajtje pa leje e armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, parashikuar nga neni 88/1 dhe 278/1 i Kodit Penal.

**15.9.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 08.07.2020, të gjyqtarit të vetëm, subjektit të rivlerësimit Arbër Çela, ka vendosur: *pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe dërgimin e çështjes në gjyq për të pandehurin A. L., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Plagosje e rëndë me dashje” dhe “Mbajtje pa leje e armëve shpërthyesë dhe municionit”, parashikuar nga neni 88/1 dhe 278/1 i K.Penal; dërgimin e çështjes për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, bashkëngjitur aktet e procedimit penal nr. {\*\*\*}, viti 2018; kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.*

**15.10.** Pas dorëzimit vullnetar të të pandehurit me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.02.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur verifikimin e kushteve për masën e sigurimit “Arrest në burg” dhe vijimin e zbatimit të kësaj mase.

**15.11.** Me kërkesë të të pandehurit A. L., është kërkuar zëvendësimi i masës së sigurimit nga “Arrest në burg” në një masë më të butë “Arrest në shtëpi dhe garanci pasurore”. Kjo kërkesë është shqyrtuar nga gjyqtari Arbër Çela, i cili me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 09.07.2020, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest shtëpie dhe garanci pasurore”.

**15.12.** Pas dërgimit të çështjes për gjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 01.02.2021, vendosi deklarinimin fajtor të të pandehurit për veprat penale “Plagosje e rëndë me dashje” dhe “Mbajtje pa leje e armëve shpërthyesë dhe municionit”, parashikuar nga neni 88/1 dhe 278/1 i Kodit Penal, dhe në bazë të nenit 55 të Kodit Penal dhe 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e tij me 5 (pesë) vjet e 4 (katër) muaj burgim. Vendim ky i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 01.04.2022.

**15.13.** Unë, gjyqtarja në pakicë, çmoj se shumica e trupit gjykues ka vlerësuar gabim kur konkludon se: *elementet e analizuara [...] janë elemente vlerësimi mbi korrektësinë dhe themelshmërinë e vendimit, mbështetur në mënyrën e vlerësimit të provave dhe në bindjen e brendshme të disponimit të subjektit të rivlerësimit në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Referuar përcaktimeve të nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, si dhe qëndrimin të mbajtur në jurisprudencën e Kolegjit, trupi gjykues vlerëson se kjo çështje e tejkalon objektin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, aftësitë gjyqësore të të cilit çmohen pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e tij.*

**15.14.** Në kushtet kur problematikat sillen në vëmendje nga organet ligjzbatuese, çmoj se nga institucionet e rivlerësimit nuk duhen vlerësuar në mënyrë strikte vetëm në kuadrin e aftësive profesionale të gjyqtarit, njohurive juridike të tij, aftësive për të vlerësuar provat dhe për të zbatuar ligjin në mënyrën e drejtë, por analiza duhet të jetë më e thellë e të evidentojë nëse jemi përpara një qëndrimi favorizues të gjyqtarit ndaj palës, që ndikon në integritetin dhe besueshmërinë e publikut ndaj tij, si qëllim kryesor i reformës në drejtësi, pasi praktika ka treguar se jo gjithmonë zbatimi i gabuar i ligjit procedural apo material vjen si pasojë e mangësisë profesionale.

**15.15.** Kodi i Procedurës Penale, në kreun IX, titulluar “Seanca paraprake” (nenet 332 deri 332/gj), ka rregulluar veprimtarinë e gjyqtarit të seancës paraprake, nga caktimi i seancës, deri në vendimmarrjen e gjyqtarit për dërgimin e çështjes në gjyq, apo pushimin e akuzës. Nenet 332/ç dhe 332/d, pika 3, parashikojnë rastet në të cilat gjykata vendos t’i kthejë aktet prokurorit, përkatësisht: (i) kur çmon se hetimet paraprake nuk janë të plota, duke urdhëruar plotësimin e tyre, duke përcaktuar drejtimin, aktet që duhet të kryhen, përsëritjen e tyre, duke caktuar dhe afatin për përfundimin e hetimeve dhe datën e seancës së re; si dhe (ii) në rastin kur prokurori nuk vepron të bëjë ndryshimet/saktësimet e cilësimit juridik të faktit penal dhe të akuzës gjatë seancës paraprake. Ashtu siç është arsyetuar edhe nga Gjykata e Apelit Shkodër, subjekti i rivlerësimit nuk duhet t’i kthente aktet prokurorit për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga “Vrasje me dashje e mbetur në tentativë” në formulimin e akuzës së “Plagosjes së lehtë me dashje”, por për plotësim hetimesh, për shkak se hetimet mund të jenë të paplota dhe duhen plotësuar me veprime të tjera hetimore për t’u dhënë përgjigje edhe pretendimeve të parashtruara nga viktimat, si dhe për të qartësuar rrethanat e faktit në raport me të gjitha provat që janë siguruar nga prokuroria.

**15.16.** Nga ana tjetër, unë, gjyqtarja në pakicë, vlerësoj se vendimmarrja e gabuar e subjektit të rivlerësimit përforcohet dhe nga disponimi prej tij, në kundërshtim me parimet kushtetuese, që garantojnë procesin e rregullt ligjor, duke ndaluar palët në proces, pa asnjë bazë ligjore, për të ushtruar ankim ndaj vendimit të dhënë prej tij, i cili nuk rezultoi i paankimueshëm, në kushtet kur me të drejtë organi i akuzës procedoi me ushtrimin e ankimit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër. Pra, ndodhemi në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2019, edhe

pse në kundërshtim të dispozitave procedurale, vendos kthimin e akteve prokurorisë për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale “Vrasje me dashje” e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 76-22 të Kodit Penal në atë të “Plagosjes së lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, ndërkohë që aktet e ekspertimit provuan se viktimat e kësaj ngjarjeje kishte pësuar dëmtime të rënda, të shkaktuara nga qitja me armë zjarri në zonën e këmbëve dhe ishte goditur në kokë me një mjet të fortë, subjekti i rivlerësimit po ashtu disponon se *kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim*.

Po kështu, lidhur me mungesën e disponimit për veprën penale “Mbajtje pa leje e armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, të konstatuar nga Gjykata e Apelit Shkodër, se: *Gjykata e Shkallës së Parë është shprehur vetëm për ndryshimin e akuzës së vrasjes së mbetur në tentativë, por nuk është shprehur lidhur me veprën penale “Mbajtje pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se për këtë vepër është shprehur në pjesën arsyetuese, kjo në asnjë mënyrë nuk duhet të mos ishte përfshirë në pjesën urdhëruese të vendimit. Kjo pjesë e vendimit përcakton saktësisht detyrimin e prokurorisë për kryerjen e detyrave të lënë nga gjykata dhe është thelbësore. Pa një pjesë urdhëruese të qartë dhe të zbatueshme, një vendim gjyqësor lë hapësirë për moszbatim të tij dhe mungesë në dhënien e drejtësisë.*

**15.17.** Në mbështetje të situatës faktike më sipër, ndonëse Komisionerja Publike, mbi bazë të rekomandimit të ONM-së, kërkon që këto mangësi të trajtohen në kuadër të njohurive ligjore të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, si një nënindikator në vlerësimin e kriterit profesional dhe/ose të konsiderohet në vlerësimin tërësor të procedurave bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, unë, gjyqtarja në pakicë, çmoj se situata e krijuar me anë të kësaj vendimmarrjeje, shkon përtej aspekteve të aftësive profesionale në njohuritë ligjore të subjektit të rivlerësimit, pasi vendimmarrja e tij duket qartazi se ka pasur për qëllim, favorizimin e të pandehurit A. L., duke vërtetuar plotësisht në këtë mënyrë konkluzionin e raportit të DSIK-së se gjyqtari Arbër Çela, përgjatë ushtrimit të detyrës së gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, dyshohet për përfshirje në veprime korruptive dhe shpërdorim detyre.

**16. Në lidhje me vendimin penal nr. {\*\*\*}, datë 12.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që u përket të gjykuarve A. L. e D. P., konstatoj:**

**16.1.** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*}, datë 03.04.2016, për veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve” e kryer në bashkëpunim, në ngarkim të të pandehurve A. L. e D. P..

**16.2.** Nga të dhënat e dosjes penale, ka rezultuar se më datë 02.04.2016, rreth orës 23:30, në vendin e quajtur lagjja “{\*\*\*}”, Shkodër, si rezultat i evidentimit në flagrancë dhe i ndjekjes nga ana e efektivëve të policisë së Komisarariatit të Policisë, Shkodër, të shtetasit A. N. L., ka rezultuar se ky shtetas është ndaluar në lagjen “{\*\*\*}”, duke qëndruar para derës së banesës së shtetasit D. P..



*Sipas Prokurorisë, në këtë kohë, në vazhdim të ndjekjes nga banesa, ka dalë shtetasi D. P., me dy qese në duar dhe ka tentuar t'ia jepte shtetasit A. L.. Menjëherë në vend kanë ndërhyrë punonjësit e policisë, dhe D. nuk ka mundur t'ia japë qeset A., dhe kur ka parë policinë i ka hedhur ato në tokë. Gjatë kontrollit dhe këqyrjes nga policia të dy qeseve në fjalë, ka rezultuar se brenda tyre kishte një masë bimore të thatë, me ngjyrë dhe erë karakteristike me lëndët narkotike të llojit "canabis sativa" dhe një pincë. Nga ana e shërbimeve të policisë, në këto rrethana, është kryer arrestimi në flagrancë i këtyre shtetasve së bashku me qeset me lëndë narkotike "canabis sativa".*

**16.3.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me kryesues të trupit gjykues subjektin e rivlerësimit Arbër Çela, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.12.2016, ka vendosur: *deklarimin e pafajshëm të të pandehurit A. L., akuzuar për kryerjen e veprave penale të "Prodhim dhe shitje e narkotikëve", parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, pasi konform nenit 388/d të Kodit të Procedurës Penale, nuk provohet të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet; konstatohet shuarja e masës së sigurimit "Arrest me burg", të vendosur me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 06.04.2016, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Shkodër, dhe lirimi i menjëhershëm i tij nga Dhomat e Paraburgimit IEVP, Shënkollm Lezhë; deklarimin fajtor të të pandehurit D. P. për veprën penale "Prodhim dhe shitje e narkotikëve", parashikuar nga neni 238/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim.*

**16.4.** Kundër këtij vendimi, ka ushtruar ankim prokurori dhe i pandehuri D. P.. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.04.2017, ka vendosur: *ndryshimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 12.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në këtë mënyrë: deklarimin fajtor të të pandehurit D. P., për kryerjen e veprës penale "Prodhim dhe shitje e narkotikëve", e parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 (shtatë) vjet burgim; deklarimin fajtor të të pandehurit A. L., për kryerjen e veprës penale "Prodhim dhe shitje e narkotikëve", e parashikuar nga 283/2 i Kodit i Penal dhe dënimin e tij me 7 (shtatë) vjet burgim.*

**16.4.1.** Në këtë vendim, Gjykata e Apelit Shkodër arsyeton se: *[...] është e vërtetë që gjatë gjykimit i pandehuri D. P. ka mbajtur qëndrimin që lënda narkotike ishte e tij dhe jo e shtetasit A. L., pra duke përjashtuar bashkëpunimin mes tyre, dhe gjykata e shkallës së parë nuk e ka marrë parasysh deklarimin e këtij shtetasi gjatë fazës së hetimeve, se lënda narkotike ishte e të pandehurit A. L. dhe ai thjesht po ia mbante në banesën e tij. Gjykata e shkallës së parë ka rrëzuar këtë provë të prokurorisë me argumentimin se bazuar në nenin 380 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata e ka të ndaluar të marrë apo të përdorë prova që nuk janë marrë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Gjykata e Apelit çmon se është e vërtetë se neni 380 i Kodit të Procedurës Penale parashikon këtë kufizim, por nga ana tjetër në nenin 362, pika 3, ky kod sanksionon se: "Deklarimet e dhëna para prokurorit ose oficerit të policisë gjyqësore mund të vlerësohen si provë, nëse ato lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre".*

**16.4.2.** Gjykata e Apelit vijon me vlerësimin se vendimi nr. {\*\*\*}, datë 12.12.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe në analizë të gabuar të

provave të administruara në gjykim, lidhur me deklarinimin e pafajshëm të të pandehurit A. L.. Gjykata e shkallës së parë ka analizuar në mënyrë krejt të gabuar dy dëshmi, të cilat janë krejtësisht të qarta në drejtim të bashkëfajësisë në këtë veprë penale. Gjykata e Apelit çmon se nga ana e prokurorisë, është provuar me prova bashkëpunimi ndërmjet të pandehurve në mbajtjen e kësaj lëndë narkotike, dhe konkludon se në këto kushte, vendimi i shkallës së parë duhet ndryshuar dhe i pandehuri duhet të deklarohet fajtor për veprën penale “Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

**16.4.3.** Kundër vendimit nr. {\*\*\*}, datë 19.04.2017, të Gjykatës së Apelit Shkodër, ka paraqitur rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër dhe të gjykuarit A. L. dhe D. P.. Nga burime të hapura, në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë, rezulton se Kolegji Penal i kësaj gjykate, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 07.02.2023, ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura, duke i dhënë fuqi vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër, për deklarinimin fajtor të dy të pandehurve.

**16.5.** Në analizë të pretendimit të Komisioneres Publike në ankim se, *bazuar dhe në rekomandimin e ONM-së, datë 06.02.2023, se çështja me palë të pandehurit A. L. e D. P. duhet të vlerësohet në kuadër të njohurive ligjore të subjektit sipas nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, indikatorit i njohurive ligjore, konkretisht nënindikatorit i lidhur me aftësinë e përgjithshme për të interpretuar ligjin, përkatësisht nenin 380 në harmoni me nenin 362, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale*, në cilësinë e gjyqtarës në pakicë, çmoj se vendimi i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të shkallës së parë, është marrë në kundërshtim me provat e administruara nga organi i prokurorisë, të cilat haptazi tregojnë bashkëpunimin e dy të pandehurve në kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, e parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, dhe me të drejtë Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e mësipërm duke e deklaruar fajtor edhe të pandehurin A. L..

**16.6.** Është e provuar tashmë se interpretimi që i bën subjekti i rivlerësimit nenit 380 të Kodit të Procedurës Penale, nuk është në përputhje me aktet e provat e administruara nga organi i prokurorisë, duke anashkaluar faktin se deklarinimet e dhëna përpara prokurorit dhe oficerit të policisë gjyqësore mund të konsiderohen provë në qoftë se lidhen me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre. Në rastin në fjalë, dëshmitë e oficerëve të policisë së shtetit dhe vetë të pandehurit D. P. provojnë fajësinë e të pandehurit A. L., fakt i cili është anashkaluar nga subjekti i rivlerësimit, duke favorizuar këtë të pandehur dhe duke e deklaruar të pafajshëm. Ecuria gjyqësore e kësaj çështjeje penale konfirmon konstatimin në raportin e DSIK-së, që subjekti përgjatë ushtrimit të detyrës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, dyshohet se është përfshirë në shpërdorim detyre dhe veprime korruptive.

**17. Në lidhje me vendimin civil nr. {\*\*\*}, datë 27.03.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që i përket kërkuases L. Gj., konstatoj:**

**17.1.** Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me gjyqtar subjektin e rivlerësimit Arbër Çela, është shqyrtuar çështja civile me nr. {\*\*\*} akti, që i përket, kërkuases L. Gj. (N.), person i interesuar

Këshilli i Qarkut Shkodër, me objekt: “Vërtetim i faktit juridik, i vendndodhjes së pronës të Rr. N. P. dhe përcaktimin e sipërfaqes së saj në hartë”. Në përfundim, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 27.03.2012, gjykata vendosi: *pranimin e kërkesës; korrigjimin e notës së transkriptit të datës 15.12.1930 në favor të shtetasit Rr. P., vetëm për sa i përket sipërfaqes së pronës së pretenduar, duke vendosur si sipërfaqe 1735 dynym, siç rezulton nga akti i ekspertimit; akti i ekspertimit është pjesë përbërëse e këtij vendimi.*

**17.2.** Në pjesën arsyetuese të vendimit të sipërcituar, rezulton se gjatë gjykimit janë trajtuar dy kërkesa procedurale të paraqitura nga përfaqësuesi i kërkueses, ajo e kalimit procedural të kërkesës nga kërkuesi, i cili është një shtetas i vdekur, te trashëgimtarja e tij L. Gj. (e cila është e përfaqësuar prej tij), si dhe kërkesa për saktësimin e objektit duke kërkuar përfundimisht: “Korrigjimin e notës së transkriptit të datës 15 dhjetor 1930 vetëm për sa i përket sipërfaqes së paraqitur”, bazuar ky kërkim në nenin 388/3 të Kodit të Procedurës Civile. Këto kërkesa janë pranuar nga gjykata me vendim të ndërmjetëm.

**17.3.** Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkueses si të bazuar në ligj, duke arsyetuar si vijon:

*Vërtetimi juridik i faktit parashikohet si institut nga neni 388 i Kodit të Procedurës Civile. Nga analiza logjike e dispozitës, del e qartë se kërkesat të cilat përmbajnë si bazë ligjore nenin 388, mund të ngrihen për dy lloj situatash juridike, të cilat ndonëse u referohen dy llojeve të ndryshme të kërimit kanë të njëjtat kushte pranimi dhe legjitimitimi procedural: (1) vërtetimin e faktit juridik kur akti që pasqyron këtë fakt ka humbur, është zhdukur dhe nuk mund të bëhet përsëri; ose (2) për korrigjimin e atyre akteve të cilat nuk mund të korrigjohen në rrugë tjetër ligjore. Në rastin në shqyrtim, kërkesa me të cilën është vënë në lëvizje gjykata, bazohet pikërisht mbi këtë bazë ligjore, konkretisht korrigjimin e notës së transkriptimit, duke pasqyruar në mënyrë të saktë sipërfaqen e pronës, në bazë të kufijve të vendosur nga vetë kjo notë.*

**17.4.** Kundër vendimit nr. {\*\*\*}, datë 27.03.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër nga kërkuësja L. Gj., përfaqësuesi i së cilës, gjatë gjykimit në apel, ka deklaruar se heq dorë nga gjykimi i padisë, pasi konflikti do të zgjidhej administrativisht. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 26.07.2012, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

**17.5.** Shumica e trupit gjykues, lidhur me vendimin objekt shqyrtimi të marrë nga subjekti i rivlerësimit, ka arsyetuar se: *subjekti i rivlerësimit nuk ka identifikuar qartë nëse kërkuësja duhet të kishte paraqitur në kuadër të këtij gjykimi nëse ajo duhet të kishte ngritur një padi, sipas nenit 32, shkronja “c” apo të paraqiste një kërkesë, sipas neneve 388 dhe 389 të Kodit të Procedurës Civile, duke konkluduar se: ka pasur mangësi në kuadër të njohurive ligjore, sipas nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, nënindikator i lidhur me aftësinë e përgjithshme për të interpretuar ligjin, konkretisht nenin 388 paragrafi 3, i ndërlidhur me nenin 32, shkronja “c” e Kodit të Procedurës*

*Civile. Duke mbajtur në konsideratë edhe që kjo mangësi është e lidhur me një vendim, prej të cilit nuk ka ardhur pasojë, pasi Gjykata e Apelit Shkodër e ka prishur atë për shkak të heqjes dorë nga kërkesa të znj. L. Gj., trupi gjykues çmoi se ai nuk mund të sjellë efekt për subjektin e rivlerësimit në vlerësimin e kriterit profesional apo në vlerësimin tërësor të procedurave bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.*

17.6. Unë, gjyqtarja në pakicë, çmoj se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në kuadër të njohurive ligjore, duke zbatuar gabim dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këto marrëdhënie. Baza ligjore e përdorur nga subjekti bie në kundërshtim me atë çfarë kërkesja ka parashtruar në kërkesën e saj drejtuar gjykatës. Situata e trajtuar nuk të vendos përpara një vërtetimi fakti juridik sipas nenit 388 të Kodit të Procedurës Civile, pasi dokumenti nuk ishte i zhdukur, nuk ishte i humbur apo nuk ishte objekt korrigjimi. Nga vendimi gjyqësor, rezulton që gjyqtari ka pranuar kërkesën e kërkuarit për saktësim të objektit të kërkesës, gjë e cila e bën të ndryshme edhe bazën ligjore të kërkesës dhe natyrën e zgjidhjes së çështjes.

17.7. Kjo mangësi e subjektit në gjykim përputhet me vlerësimin e Komisioneres Publike, bazuar dhe në rekomandimin e ONM-së, se në gjendjen që rezultojnë aktet, kjo çështja civile duhet të vlerësohet në kuadër të njohurive ligjore të subjektit sipas nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, indikatorin e njohurive ligjore, konkretisht nënindikatorin e lidhur me aftësinë e përgjithshme për të interpretuar ligjin, përkatësisht nenin 388, paragrafi 3, i ndërlidhur me nenin 32, germa “c” e Kodit të Procedurës Civile, pasi nuk rezulton se jemi para kushteve të domosdoshme për vërtetim gjyqësor të faktit, gjykimi *grazios*, pasi nota e transkriptimit e datës 15 dhjetor 1930, nuk ka humbur, nuk është zhdukur apo lind nevoja për t’u marrë në një rrugë tjetër, sikurse edhe nuk është objekt korrigjimi apo gabim sipërfaqja nga 60 dynymë në aktin “Notë transkriptimi”, në 1753 dynymë në disponimin e vendimit gjyqësor.

18. Në përfundim, lidhur me gjetjet në këto tri çështje, referuar informacionit të organit ligjzbatues, me të njëjtin arsyetim si Komisionerja Publike, vlerësoj se *rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuara së bashku me rezultatet e tjera të hetimit, përfshirë vlerësimin e aftësive profesionale, në vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, si dhe të para në raport me njëra-tjetrën, duhen çmuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*

**19. Denoncimi i znj. R. H., parë në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale:**

19.1. Në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.02.2015, që i përket kërkesës penale me kërkuar M. Q., person i interesuar Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2011, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër”, gjyqtari i vetëm, subjekti i rivlerësimit Arbër Çela, ka vendosur pushimin e gjykimit të kërkesës penale. Në këtë vendim, arsyetohet se: *Në rastin konkret, kërkuari M. Q. nuk u paraqiti, megjithëse kishte dijeni për seancën gjyqësore nga seanca e kaluar, ajo e datës 04.02.2015, në të*

*cilën ka qenë prezent dhe nuk kishte paraqitur asnjë shkak për të justifikuar mungesën [...] Gjykata, në vështrim të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, çmon se gjykimi i kërkesës së kërkuarit M. Q. duhet pushuar.*

**19.2.** Pas ankimit të ushtruar nga kërkuari, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur prishjen e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 12.02.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe kthimin e akteve për rigjykim me një tjetër trup gjykues. Gjykata e Apelit, ndër të tjera, ka arsyetuar se vendimi objekt shqyrtimi është dhënë në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal e të vendimit unifikues nr. 2, datë 20.06.2013, të Gjykatës së Lartë.

Gjykata e Apelit Shkodër, në këtë vendim, shprehet se: *gjykata e shkallës së parë ka refuzuar të shqyrtojë kërkesën objekt ankimi dhe përtej çdo parashikimi të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pushimin e gjykimit duke nxjerrë kështu një akt jonormal, akt i cili konsiderohet i çuditshëm e që nuk mund të eliminohet, por vetëm nëpërmjet kundërshtimit të tij. [...] Gjykata e shkallës së parë duhej të zbatonte nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, duke shqyrtuar kërkesën e paraqitur pa praninë e kallëzuesit të krimit dhe, në përfundim, të vendoste sipas alternativave që i lejon dispozita procedurale penale, pra të merrte në shqyrtim të gjitha pretendimet e kërkuarit që kishin të bënin me vendimin e mosfillimit të procedimit penal [...] dhe duke verifikuar gjendjen e akteve, të veprimeve të kryera nga organi i akuzës për mbledhjen e të dhënave apo të kryerjes së veprimeve hetimore, të konkludonte nëse ato janë të mjaftueshme që të japin të dhëna në lidhje me ekzistencën apo jo të faktit penal, duke vendosur sipas rastit rrëzimin e kërkesës ose shfuqizimin e vendimit të prokurorit e rifillimin e hetimeve.*

**19.3.** Gjykata e Apelit Shkodër ka arritur në konkluzionin se nga gjykata e shkallës së parë është dhënë një vendim i pabazuar, i pambështetur në asnjë dispozitë ligjore, duke vendosur përtej çdo parashikimi të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, pushimin e gjykimit. Sipas kësaj gjykate, arsyetimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë nuk i përgjigjet objektit të kërimit, si në pjesën arsyetuese, ashtu edhe në pjesën urdhëruese, duke qenë një aktvendim i pavlefshëm.

**19.4.** Në ndryshim nga shumica e trupit, çmoj se pretendimi i Komisioneres Publike se *qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në vendimin e datës 12.02.2015, për pushimin e çështjes, lidhur me nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, për shqyrtimin e ankimit në rastin kur palët nuk paraqiten pa shkaqe të arsyeshme, nuk gjen mbështetje në situatën juridike të rastit konkret, pasi ligji procedural për ankimet ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nuk parashikon pushimin e gjykimit duke evidentuar minimalisht dobësi/mangësi në aftësitë profesionale të subjektit, është i bazuar. Me të njëjtin arsyetim si Komisionerja Publike, vlerësoj se të dhënat e rezultuara në këtë rast, duhen mbajtur në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*

**20.** Në përfundim, mbështetur në sa më sipër arsyetuar, problematikat e evidentuara për pasurinë apartament, me sipërfaqe 91,91 m<sup>2</sup>, si dhe ato të konstatuara në kuadër të kontrollit të figurës dhe

vlerësimit të aftësive profesionale, me bindje të plotë, e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e zbatimit të nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, për deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë dhe cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Në vlerësimin tim, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivelin e besueshmërisë sipas nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 për t'u konfirmuar në detyrë dhe, për këto arsye, kam votuar kundër shumicës së trupit gjykues, duke kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 595, datë 07.12.2022, të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arbër Çela.

**GJYQTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*